

Udhëzues

i thjeshtë dhe praktik

për një umre

të sukseshme dhe të paharrueshme

Kastriot Bardhi

Titulli i librit:

**Udhëzues i thjeshtë dhe praktik
për një umre të sukseshme dhe të paharrueshme**

Përgatiti:

Kastriot Bardhi

Redaktoi:

Valmira Bardhi

Korçë,
Nëntor 2023

PARATHËNIE

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Duke u nisur nga dëshira për t'u ardhur sadopak në ndihmë vizitorëve të Qabes, nëpërmjet këtij libri të vogël e të thjeshtë kam synuar që të paraqes në mënyrë konkrete e hap pas hapi ritualet që ata do të kryejnë në udhëtimin e tyre të jetës drejt Tokave të Shenjta, duke filluar nga vizita e Xhamisë së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Medinen e Ndritshme, siç e kanë bërë tashmë zakon shqiptarët, për të vazhduar me veshjen e ihramit nga mikati i Dhul Hulejjes dha pastaj me kryerjen e riteve të umres në Xhaminë e Shenjtë në Mekën Fisnike.

Udhezuesi është i pajisur me informacione fetare, kulturore, historike, gjeografike etj. që ua shtojnë njohuritë vizitorëve të këtyre dy qyteteve shumë të dashura për gjithë besimtarët e mbarë botës. Ndërsa kapitulli i fundit i librit përmban një buqetë lutjesh të përzgjedhura nga Kurani dhe Suneti, që u vijnë në ndihmë besimtarëve gjatë kryerjes së riteve të umres.

E lus Allahun ta pranojë këtë vepër modeste që në radhë të parë të fitoj kënaqësinë e Tij, dhe njëkohësisht të na bëjë dobi të gjithëve.

Autori

KAPITULLI I

TË NJOHIM MEDINEN E PROFETIT (PAQJA E ALLAHUT QOFTË MBI TË!)

Medina e Ndriritshme

- Medina e Ndriritshme është vendi i shpërnguljes së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); vendi ku ai banoi dhe ndërroi jetë; atje është varri ku prehet trupi i tij i nderuar.
- Pas Mekës, është qyteti i dytë më i shenjtë për muslimanët.
- Gjithashtu është kryeqyteti i parë i Islamit dhe bërthama e qytetërimit islam, drita e të cilit u përhap në mbarë botën.

Në këtë udhëzues do të gjeni informacionet dhe udhëzimet më të rëndësishme për një vizitë të veçantë në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Vlerat e mirësitë e Medines

Qyteti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është vendi i dytë më i shenjtë në Islam. Allahu i ka dhënë këtij qyteti shumë vlera të veçanta, ndërmjet të cilave përmendim:

Medina është atdheu i Islamit dhe udhëzimit:

Qyteti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka qenë dhe do të mbetet atdheu i Islamit dhe udhëzimit; prej tij del dhe tek ai kthehet, rritet dhe forcohet besimi, siç ka

thënë ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *“Në të vërtetë, besimi kthehet e mblidhet në Medine, ashtu siç kthehet gjarpri në folenë e tij.”*

Ndërmjetësimi i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) për banorët e Medines:

Ai që banon në këtë qytet dhe bën durim ndaj vështirësive të tij ka një avantazh të madh, sepse Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) do të ndërmjetësojë për të në Ditën e Gjykimit, siç ka thënë: *“Kushdo që i duron fatkeqësitë e vështirësitë e jetës në të (në Medine) dhe vdes i tillë (si durimtar), sigurisht që unë do të ndërmjetësoj për të (në Ditën e Gjykimit).”*

Medina është qytet i bekuar:

Bekim (bereket) do të thotë bollëk i madh dhe shtim i të mirave. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) iu lut Allahut ta bekojë ushqimin e këtij qyteti, rizkun e tij dhe të gjitha veprat që bëhen në të: *“O Zoti ynë! Bekoji frutat tona, bekoje Medinen tonë, bekoje sa'in dhe muddin (njësi matëse) tonë! O Zoti im! Vërtet, Ibrahimimi është Robi Yt, Miku dhe Profeti Yt; edhe unë jam Robi dhe Profeti Yt. Ai t'u lut për Mekën; ndërsa unë po të lutem për Medinen, ashtu siç t'u lut ai për Mekën. Të lutem, o Zoti im, bekoje Medinen tonë dhe dyfishoje bereqetin e saj!”*

Është vend i shenjtë:

Medina është vend i shenjtë, në të cilin shumëfishohen veprat e mira dhe zmadhohen veprat e këqija; dëmtimi i njerëzve të saj konsiderohet prej mëkateve më të mëdha tek Allahu.

Emrat e Medines:

Qyteti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka emra që përmbajnë kuptime të mëdha. Ndër emrat e këtij qyteti janë:

Medina (Qyteti): Çdo qytet shoqërohet nga një emër apo përemër që shpreh marrëdhënie përkatësie me të (apo përdoret i shoqëruar me emra me funksione përcaktues), përveç qytetit të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), pasi ai është “Qyteti” i përcaktuar në vetvete.

Më pas, ai përshkruhet si **Qyteti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)**, sepse realisht Medina është qyteti i tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Gjithashtu ai përshkruhet si **Qyteti i Ndrithëm**, për shkak të dritës së Mustafait – të Zgjedhurit të Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), i cili, pas shpërnguljes në Medine, e ndriçoi atë nëpërmjet fesë islame.

Daru el Hixhra (Vendi i Emigrimit): Sepse ky qytet fitoi nderin e vendit mikpritës së Profetit (Paqja e Allahut qoftë

mbi të!) dhe shokëve të tij; u bë shtrehë për ta, përkrahës dhe mbrojtjes i tyre.

Taiba (i Mirë): Është qytet i mirë, i bukur, i mrekullueshëm dhe i pastër, për shkak të bekimit dhe dëlirësisë së këtij vendi, të mirësisë së banorëve të tij dhe mirësisë së jetesës në të.

Xhamia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

- Vizita në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është sunet (vepër e pëlqyer).
- Nuk ka ndonjë kohë specifike për ta vizituar; kështu që vizitori mund ta vizitojë Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) gjatë gjithë vitit.

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Asnjë udhëtim nuk duhet të ndërmerret (për vizitë), përveçse në tri xhamitë: në Xhaminë e Shenjtë (Qabja), në këtë Xhami - në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) - dhe në Xhaminë Aksa.”*

Nga etiketa e vizitës në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

- Hyni me këmbën e djathtë.
- Thoni lutjen e hyrjes në xhami.
- Dilni nga xhamia me këmbën e majtë.

- Thoni lutjen e daljes nga xhamia.
- Falni namazin në Kopshtin e Nderuar (Er-Reudatu esh-Sherifetu), pasi të keni marrë lejë për t' u falur atje. Por, kujdesuni që të shmangni kohët e dyndjes së njerëzve.
- Lutuni dhe përmendeni Allahun shumë.
- Përshëndetni me selam Profetin Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe dy shokët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), duke respektuar rregullat e etikës islame.
- Shfrytëzoni kohën maksimalisht, duke u kujdesur në mënyrë të veçantë që (pesë) namazet e detyrueshme t' i falni në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Një namaz në Xhaminë time është i barabartë me një mijë namaze që falen në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë (Qabesë).”*

Xhamia Kuba

- Është xhamia e parë e ndërtuar në Islam.
- Këtë xhami e ndërtoi Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) para se të vendosej në Medine.
- Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) qëndroi 4 ditë në Kuba. Në ditën e pestë, ai u nis në drejtim të Medines bashkë me Ebu Bekër es-Sidikun (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

- Allahu i Lartësuar ka thënë:

لَمَسْجِدٍ أُسِّسَ عَلَى التَّقْوَىٰ مِنْ أَوَّلِ يَوْمٍ أَحَقُّ أَنْ تَقُومَ فِيهِ، فِيهِ رِجَالٌ يُحِبُّونَ أَنْ يَتَطَهَّرُوا وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُطَهَّرِينَ

“Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.”

Vlera e xhamisë Kuba:

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e vizitonte xhaminë Kuba, falej në të dhe thoshte: *“Kush pastrohet (merr abdes ose gusël) në shtëpinë e tij, pastaj vjen në xhaminë e Kubasë dhe e fal namazin atje (namaz vullnetar apo të detyrueshëm), atij do t’i jepet shpërblimi i umres.”*

Vendndodhja: Ndodhet në jugperëndim të Medines, në një zonë të pasur me plantacione palmash.

Të dhëna për xhaminë e Kubasë:

- Sipërfaqja e përgjithshme e xhamisë arrin deri në 13 500 m².
- Kapaciteti: Në të mund të falen deri në 25 000 besimtarë në të njëjtën kohë.

Projekti i Mbretit Selman për të zgjeruar xhaminë, “Kubaja në vitin 1443 hixhri”:

- Ky është zgjerimi më i madh në historinë e xhamisë Kuba.
- Synon zgjerimin e xhamisë dhe zhvillimin e zonës përreth saj.
- Nga ky zgjerim, sipërfaqja totale e saj rritet deri në 50 000 m².
- Kapaciteti: Në të mund të falen deri në 66 000 besimtarë në të njëjtën kohë.

Shëtitorja e Kubasë

Është një rrugë e gjerë për këmbësorët që lidh Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) me xhaminë Kuba. Ajo ofron mundësitë më të mira për lëvizjen dhe shëtitjen këmbësorëve nga Xhamia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në xhaminë Kuba dhe anasjelltas. Shëtitorja është e mbushur me dyqane, kafene dhe ushqime tradicionale vendase. Vendkalimi është i gjatë 3.6 km. Një pjesë e saj mund të kalohet në këmbë, për të shijuar atmosferën e Medinës. Kjo pjesë mund të konsiderohet si një park për të rritur dhe fëmijë. Është e përshtatshme për të ecur gjatë natës në mot të nxehtë.

Xhamia e Kibletejnit (Xhamia e Dy Kibleve)

Është xhamia në të cilën për herë të parë u bë ndryshimi i Kibles. Në kohën kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ishte në Mekë, teksa falte namazin, drejtohej kah Jeruzalemit (Bejtu el Makdis), ndërsa Qaben e kishte përballë, midis tij dhe Jeruzalemit. Kur emigroi në Medine, qëndroi më shumë se një vit duke u falur kah Jeruzalemit, teksa i pëlqente të drejtohej kah Qabesë, derisa Allahu i Lartësuar zbriti ajetin kuranor:

قَدْ نَرَىٰ تَقَلُّبَ وَجْهِكَ فِي السَّمَاءِ فَلَنُوَلِّيَنَّكَ قِبْلَةً تَرْضَاهَا فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ
الْحَرَامِ

“Ne të pamë ty (Muhamed) që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga Kibla që të kënaq ty. Prandaj, ktheje fytyrën tënde nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja)!”

Kështu që ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u drejtua kah Qabesë. Thuhet se kjo ndodhi kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ishte te fisi Benu Seleme, duke i udhëhequr besimtarët në namazin e drekës. Pasi fali me ta dy rekatet e para të drekës, iu shpall ajeti që e urdhëronte të drejtohej kah Qabesë. Kështu ai u drejtua kah Qabesë, teksa ata ishin duke u falur; besimtarët që faleshin pas tij gjithashtu ndërruan drejtimin e faljes. Prandaj xhamia u quajt “Kibletejni” (Xhamia e Dy Kibleve). Ndodhet 4 km nga Xhamia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), në zonën Beni Seleme.

Xhamia e Ixhabes -Përgjigjes (xhamia Beni Muauije - xhamia el Mubahele)

- Është një xhami e lashtë historike, e ndërtuar në kohën e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Arsyeja e emërtimit të kësaj xhamie lidhet me lutjen e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), dhe përgjigjen ndaj saj (pranimin e saj).
- Ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kaloi pranë kësaj xhamie dhe fali dy rekate në të. Ndërkaq, disa nga sahabët u falën me të. Pastaj Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) iu lut Allahut, duke i kërkuar tre gjëra. Nga kjo lutje, iu plotësuan dy kërkesa dhe iu refuzua e treta.
- Xhamia e Ixhabes (Përgjigjes) - ndodhet në verilindje të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Pas zgjerimit, ajo është 580 m larg Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Xhamia aktuale është ndërtuar në vendin e xhamisë së vjetër, në kohën Mbretërisë së Arabisë Saudite
- Ka një sipërfaqe prej rreth 500 m²
- Xhamia është në dispozicion për të gjithë ata që duan të falin namazin në të.

Xhamia el Gamame

- Një xhami e ngritur në vendin ku Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) falte namazin e Bajramit dhe namazin për kërkimin e shiut.
- Është rreth 500 m larg Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), nga ana jugperëndimore

Arsyeja e emërimit: Quhet “el Gamame”, sepse Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) fali në të namazin për kërkimin e shiut. Gjithashtu thuhet se një re e mbuloi diellin, kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) po falej në këtë vend.

- Xhamia është ndërtuar në kohën e sundimit të kalifit Umer bnu Abdulaziz në Medine. Kësaj xhamie i janë bërë rikonstruksione të njëpasnjëshme përgjatë shekujve. Punimet e planifikuara në ditët e sotme synojnë ruajtjen e stilit të saj arkitektonik. Në këtë xhami falen pesë namazet ditore, përveç namazit të xhumasë.

Xhamia Ebu Bekër es-Sidik (Allahu qoftë i kënaqur me të!)

- Kjo xhami është ndërtuar në vendin ku Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u printe banorëve të Medines në namazin e Bajramit gjatë periudhës kur ai ishte udhëheqës i muslimanëve. Ajo ndodhet afër vendit ku Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) falte Bajramin.
- Është shumë afër xhamisë el Gamame.

- Është një nga xhamitë historike që ka ruajtur stilin e vjetër; performanca e saj i tërheq shumë vizitorët.
- Xhamia është ndërtuar në kohën e sundimit të kalifit Umer bnu Abdulaziz në Medine.
- Xhamia ruan ende murin e saj prej guri të zi dhe stilin e saj të vjetër. Ajo ka ruajtur të njëjtën formë që kur është ndërtuar në vitin 1254 hixhri.

Vizitorët mund ta shohin xhaminë nga afër dhe të bëjnë fotografi në oborrin e saj të jashtëm.

Xhamia Umer bnu el Hatab (Allahu qoftë i kënaqur me të!)

- Kjo xhami është ndërtuar në vendin e faljes së Bajramit në kohën e udhëheqësit të muslimanëve Umer bnu el Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!)
- Xhamia ndodhet në anën jugperëndimore të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Ndodhet 455 m larg nga godina e zgjerimit të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Xhamia është ndërtuar për herë të parë pas vitit 850 hixhri.

Xhamia Ali bnu Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur me të!)

- Kjo xhami është ndërtuar në vendin e faljes së Bajramit në kohën e udhëheqësit të muslimanëve Ali bnu Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur me të!)
- Xhamia ndodhet në anën perëndimore të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Është afërsisht 400 m larg Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Xhamia është ndërtuar në kohën e sundimit të kalifit Umer bnu Abdulaziz në Medine.
- Kjo xhami është restauruar gjatë epokës së Mbretërisë së Arabisë Sauditë në vitin 1411 hixhri.

Varreza e Bekies

Varreza “Bekia” e Medines Profetike është nga koha e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e deri më sot. Përgjatë shekujve në të janë varrosur shumë njerëz të shquar, në mesin e të cilëve dhe disa nga nënat e besimtarëve (gratë e Profetit - Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe një numër i madh i sahabëve të nderuar (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Bekia ndodhet në juglindje të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

- Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 180 000 m².

Quhej “Bekia”, sepse dikur në të kishte shumë pemë; el Bekiu quhet një vend i gjerë me varietete pemësh të larmishme.

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i vizitonte shpesh njerëzit e varrosur në Bekie dhe lutej për ta.

Burrat mund të vizitojnë varrezat e Bekies:

- Pas namazit të sabahut deri në orën tetë.
- Pas namazit të ikindisë për një orë.
- Menjëherë pas namazeve të detyrueshme, nëse ka xhenaze.

Mali i Uhudit

- Është një mal madhështor; është një vend i veçantë për Profetin. Ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Uhudi është një mal që na do dhe ne e duam atë.”*
- Pranë këtij mali u zhvillua një nga betejat më të mëdha të Islamit, beteja e Uhudit, në të cilën ranë shehid (martirë) 70 sahabë, midis të cilëve edhe zotëriu i dëshmorëve, Hamza bnu Abdul Muttalibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!).
- Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) shpesh e merrte si shembull Uhudin për madhështinë e tij, si në rastin kur i lavdëroi shokët: *“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur dikush prej jush të shpenzonte (në rrugë të*

Allahut) një sasi ari sa mali i Uhudit, nuk do të arrinte as e (shpërblimin për) një grushti ar që ka shpenzuar ndonjëri prej tyre (sahabëve), madje as sa gjysma e tij.”

- Është rreth 4 km në veri të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Pse u quajt “Uhud”, sepse ai është unik, dallohet nga malet rreth tij; ai shfaqet i ndarë nga pjesa tjetër e maleve.

Ky mal shkon në formë zinxhiri nga lindja në perëndim dhe anohet drejt veriut. Përmasat e përafërta të tij:

- Gjatësia: 7 km
- Gjerësia: 2 - 3 km
- Lartësia mbidetare: deri në 1077 m
- Ngjyrat e shkëmbinjve malorë janë të larmishme, ku bie në sy graniti i kuq; disa prej tyre kanë tendencë në jeshile të errët dhe të zezë.
- Ka shumë shpella, çarje dhe zgavra që bllokojnë ujin e shiut.

Kur shkon Uhud, vizitori do të shohë:

- **Malin e Uhudit**
- **Kodrën e Shigjetarëve**
- **Varreza e Dëshmorëve**

Kodra e Shigjetarëve

• Është një kodër e vogël, që ndodhet pranë malit të Uhudit. Arsyeya e emërtimit: Sepse Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i urdhëroi shigjetarët gjatë betejës së Uhudit të ngjiteshin në kodër dhe të qëndronin atje, me qëllim ta mbronin ushtrinë muslimane; t'i ruanin ata (muslimanët) nga rrethimi i armiqve. Numri i shigjetarëve ishte pesëdhjetë (sahabë). Nën udhëheqjen e Abdullah bnu Xhubejrit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Allahu pati caktuar që disa nga shigjetarët të mos respektonin urdhrin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Teksa panë që politeistët ishin mundur dhe po ia mbathnin këmbëve, ata zbritën për të mbledhur plaçkat e luftës. Komandanti i tyre, Abdullah bnu Xhubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u përpoq t'i pengonte. Halid bnu Uelidi e shfrytëzoi atë moment - në atë kohë ishte politeist - dhe e ktheu skuadrën e tij kundër ushtrisë muslimane. Kështu që rezultati i betejës ndryshoi dhe fitorja e muslimanëve u shndërrua në disfatë. Në atë betejë u vranë shumë sahabë (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Allahu i Lartësuar thënë:

أولما أصابتكم مصيبة قد أصبتم مثليها قلتم أنى هذا قل هو من عند أنفسكم

“Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqtë tuaj dyfish, ju thatë: “Prej nga na erdhi neve kjo?!” Thuaj (o Muhamed): ‘Kjo ndodhi prej jush.’”

Varreza e Dëshmorëve të Uhudit

- Ndodhet në veri të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), 5 km larg Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), në bazën e malit të Uhudit. Zona e kësaj varreze quhet “Sheshi i Dëshmorëve”
- Varrezat u quajtën me këtë emër, sepse aty prehen trupat e 70 sahabëve fisnikë, që ranë dëshmorë në luftën e Uhudit. Aty u varrosën sahabët më të njohur (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), ndër të cilët: Zotëriu i dëshmorëve, Hamza bnu Abdul Mutalibi, xhaxhai i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).
- Varreza sot është rrethuar me një mur nga të gjitha anët, duke i lejuar vizitorët të shohin se çfarë ka brenda.

Është sunet (e pëlqyer) që vizitorët t’i përshëndesin banaorët e varrezave dhe të lutën për ta, siç lutej Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

“Es-selâmu alejkum ehled-dijâri minel mu’minîne uel muslimîne ue in-nâ inshâAll-llâhu bikum lâhikûn, ue jerrhamull-llâhu el mustekdimîne min-nâ uel muste’hirîn, es’elull-llâhe lenâ ue lekumul âfijeh!

(Paqja qoftë mbi ju, banorë të varrezave, besimtarë dhe muslimanë! Edhe ne - në dashtë Allahu - do t’ju bashkangjitemi juve! Allahu i mëshiroftë ata që kanë vdekur para nesh dhe ata që do të vdesin më vonë!)”

Kulla e Benu Saides

Është vendi ku u mbledhën sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) pas vdekjes së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), për të zgjedhur udhëheqësin e muslimanëve. Ata zgjedhën Ebu Bekër es-Sidikun (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Quhet kulla e Beni Saides, sepse ajo i përkiste fisit Beni Saide, i cili gjithashtu kishte një fermë në këtë vend. Është një nga monumentet historike më të rëndësishme në Medine. Ajo zë një vend të madh në ndërgjegjen e muslimanëve, për shkak të vlerës historike të monumentit, që buron nga ngjarja që ka ndodhur në të. Ndodhet në veriperëndim të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Është rreth 500 m larg saj. Ishte një objekt i vjetër, me çati të gjerë, me 3 mure dhe një anë të hapur. Ndërsa në kohën tonë, vendi i kullës është një kopsht brenda një muri. Zona është si një kopsht në të cilin vizitori ecën mes pemëve të shumta, për t'u njohur me këtë vend të lashtë arkeologjik.

Kompleksi i Mbretit Fehd për Shtypjen e Kuranit të madhërishëm

Është një kompleks pionier në shërbim të Kuranit të madhërishëm dhe shkencave të tij, për përkthimin e kuptimeve të Kuranit dhe mbrojtjen e tekstit kuranor nga shtrembërimi; të gjitha këto realizohen përmes përdorimit optimal të teknologjisë së avancuar në fushën e printimit,

regjistrimeve audio, botimit elektronik dhe aplikacionetve dixhitale. Kompleksi ka shtypshkronjën më të madhe në botë për botimin e Kuranit të madhërishëm. Është një nga veprat më madhështore që Mbretëria e Arabisë Saudite ofron në shërbim të Islamit dhe muslimanëve. Deri më tani, janë shtypur më shumë se 350 milionë kopje të Kuranit. Në këtë kompleks shtypen rreth 20 milionë kopje në vit. Janë shtypur e botuar më shumë se 250 kopje të të gjitha madhësive dhe përkthimeve. Kurani i madhërishëm është shtypur e botuar në më shumë se 70 gjuhë në botës, duke përfshirë 39 gjuhë aziatike. Është inaguruar në vitin 1405 hixhri.

Muzeu i Medines (Muzeu i Stacionit Hekurudhor Hixhaz)

Në vitin 1983 filloi një projekt për të transformuar Stacionin Hekurudhor Hixhaz, i cili u ndërtua në 1908, në një muze i njohur me emrin “Muzeu i Medines”.

Koleksionet: Janë koleksione të ndryshme arkeologjike, ekspozita vizuale dhe foto të rralla, që lidhen me Medinen ndër shekuj. Janë përafërsisht 2 000 gjetje arkeologjike, që mishërojnë trashgiminë kulturore të Medines. Ato dokumentojnë peizazhin, aspektet demografike dhe mënyrën e transformimit të qytetit është përgjatë shekujve. Muzeu ndodhet në Medine, në ndërtesën e stacionit që është stacioni i fundit i hekurudhës së Hixhazit, afër xhamisë Anberije.

Muzeu “Daru el Medine”

për Trashëgiminë Urbane dhe Kulturore

Është muzeu i parë i specializuar në shfaqjen e historisë civilizuese, kulturore dhe islame të Medines, nga shpërngulja (hixhreti) e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) deri në epokën e sotme. Muzeu përcjell tek ju një përvojë të pasur, përmes historisë së Medines, Xhamisë së Profetit dhe jetës së tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Udhërrëfyesit, brenda muzeut, ju japin informacione në gjuhë të ndryshme, përmes shpjegimeve të hollësishme, në të cilat pasqyrohen:

- Koleksione me karakter historik dhe arkeologjik.
- Stereograme historike.
- Piktura, vizatime, mbishkrime, shkrime dhe dorëshkrime.

Ekspozita e Arkitekturës së Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

- Arkitektura e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është dëshmitare e bukurisë dhe saktësisë së arkitekturës islame dhe trashëgimisë së lashtë historike që përmban kjo xhami. Kjo ekspozitë synon të pasurojë përvojën e vizitorit dhe të nxjerrë në pah aspektet e

arkitekturës së Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe shërbimeve të ofruara në të.

Vendi i ekspozitës: gjendet në anën jugore (në drejtim të Kiblës) të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

- Ekspozita pasuron eksperiencën e vizitorëve, duke pasqyruar objektet më të rëndësishme të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), si: minberi, mihrabi, kupolat, çadrat, dyert, minaret etj.
- Objektet e ekspozuara prezantohen me metodat më të fundit të teknologjisë dhe në disa gjuhë të botës përmes 12 pajisjeve që paraqesin pamje stereoskopike tredimensionale:
- Shfaqet historia e arkitekturës së Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) që nga themelimi i saj.
- Zgjerimet që ka pësuar xhamia përgjatë historisë.

Vizitorët duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të ruajtur koleksionet e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); ekspozita është dëshmi e ndërgjegjësimit të tyre.

Ekspozita dhe Muzeu Ndërkombëtar për Biografinë e Profetit dhe Qytetërimin Islam

Është një paraqitje e bukur dhe gjithëpërfshirëse e biografisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), etikës

dhe shariatit të tij, përmes një qasje metodike të veçantë shkencore, bazuar në kërkime shkencore me karakter rrënjësor; janë përdorur risi teknike unike dhe prezantim krijues inovativ. Ndhodhet në rajonin jugor përballë Kiblës së Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Ekspozita synon:

- Njohjen e Allahut të Lartësuar përmes emrave, cilësive dhe dëshmive të fuqisë së Tij.
- Prezantimin e Islamit, të vlerave dhe parimeve të tij.
- Prezantimin e jetëshkrimit të Profetit të Islamit, Muhamedit të birit të Abdullahit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).
- Prezantimin e profetëve dhe të dërguarve (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!).
- Prezantimin e trashëgimisë islame dhe monumenteve të qytetërimit islam.

KAPITULLI II

**UDHËZUESI PËR KRYERJEN E RITEVE
NË XHAMINË E PROFETIT
(PAQJA E ALLAHUT QOFTË MBI TË!)**

Xhamia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Është xhamia e dytë më e madhe në Islam pas Xhamisë së Shenjtë (Qabesë). Është ndërtuar nga Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe shokët e tij, pas shpërnguljes së tyre në Medine. Medina ishte qendër e dijes (shkencës) dhe qytetërimit; atje u recitua Kurani dhe u mbledhën sahabët me Profetin tonë fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), duke përfituar nga bekimi dhe udhëzimi i tij.

Shumëfishimi i shpërblimit të namazeve

Namazi që falet në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) shpërblehet shumëfish, siç ka thënë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *“Një namaz në Xhaminë time është i barabartë me një mijë namaze që falen në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë (Qabesë).”*

Udhëtimi për të vizituar Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Është e pëlqyeshme që muslimani - nëse ka mundësi - të udhëtojë për të falur namazin në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), siç ka thënë ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *“Asnjë udhëtim nuk duhet të ndërmerret (për vizitë), përveçse në tri xhamitë: në Xhaminë e Shenjtë (Qabja), në këtë Xhami - në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) - dhe në Xhaminë Aksa.”*

Muslimanët janë kujdesur në mënyrë të vazhdueshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e saj, duke ndjekur shembullin e të Dërguarin e tyre fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Xhamia është zgjeruar më shumë se një herë nga mbretërit e Mbretërisë së Arabisë Saudite. Sipërfaqja e saj tani ka arritur më shumë se 500 000 m², pas zgjerimeve që Arabia Saudite i ka bërë Xhamisë, kateve dhe oborrit të saj për faljen e namazit. Në kohën e pikut, në këtë Xhami numri i besimtarëve që falen arrin deri në 100 000.

Pjesët përbërëse të Xhamisë

Xhamia e Vjetër: Është Xhamia në të cilën është falur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ajo ruan formën e saj historike dhe mbishkrimet e lashta.

Es-Serhatu: Janë dy zona të ekspozuara radhazi pas Xhamisë së Vjetër. Në të kaluarën, ato kanë qenë të shtruara me guralecë, për këtë arsye u quajt *serhatu-guralecë*. Në kohën tonë, ka çadra që hapen automatikisht gjatë ditës për mbrojtjen e besimtarëve nga dielli dhe mbyllen natën për të ajrosur Xhaminë.

Zgjerimet: Këto janë ndërtesat e tjera të Xhamisë që rrethojnë dy zonat e ekspozuara - es-Serhatu.

Oborret: Janë zona të mëdha të përgatitura për besimtarët, të mbuluara me çadra që hapen dhe mbyllen automatikisht, për t'i mbrojtur ata nga dielli; gjithashtu oborret janë me ajrim dhe spërkatje, për të krijuar kushte atmosferike të përshtatshme për besimtarët që falen.

Sipërfaqja: 235 000 m² Kapaciteti: 450 000 besimtarë

Xhamia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në gjuhën e shifrave:

Dyer të brendshme dhe të jashtme: 229

Kupola fikse dhe të lëvizshme: 196

Minaret: 10 Raftet e Kuranit: 10496

Çadrat në oborr dhe brenda Xhamisë: 262

Ventilatorët e spërkatjes me ujë: 424

Dhoma e Nderuar (El Huxhratu esh-Sherife)

Dhoma e Nderuar quhet shtëpia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), në të cilën ai banoi me nënën e besimtarëve, Aishen të bijën e Ebu Bekër es-Sidikut (Allahu qoftë i kënaqur me ata të dy!). Allahu i Lartësuar e nderoi Aishen duke vendosur në dhomën e saj varrin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe dy shokët e tij: Ebu Bekrin dhe Umerin (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!)

Kjo Dhomë e Nderuar ndodhet në juglindje të Xhamisë së Profetit fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Nëpërmjet një derë, ajo kishte dalje të drejtpërdrejtë në Kopshtin e Nderuar (Er-Rauda esh-Sherife). Për këtë arsye, teksa kishte hyrë në itikaf në xhami, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e afronte kokën, që Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) t'ia krihte flokët.

Kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u sëmur rëndë, në momentet e fundit të jetës së tij, ishte në dhomën e Aishes, pasi, më parë, u kishte kërkuar leje nënave të besimtarëve (grave të tij) që kur të sëmurej, të qëndronte në dhomën e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!); dhe ato i patën dhënë leje.

Kur ndërroi jetë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), u varros aty ku vdiq, sepse ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) pati thënë: *“Çdo profet varroset aty ku vdes.”* Kështu që Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u varros pikërisht në këtë dhomë. Pastaj aty u varrosën dy shokët e tij: Ebu Bekri dhe Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!).

Dhoma mbeti jashtë Xhamisë dhe më pas hyri në të, për shkak të zgjerimeve të mëvonshme që iu bënë asaj. Muslimanët u kujdesën shumë për ta mbrojtur Dhomën e Nderuar nga çdo rrezik i mundshëm, si: shirat e rrëmbyeshëm, përmbytjet apo nga armiqtë e Islamit:

Përmes një ndërtese dhe mureve që ruajnë Dhomën e Nderuar, përmbushet amaneti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) që varri i tij të mos bëhej vend adhurimi e të

mos vizitohej periodikisht, ku njerëzit mund të bënin në gjynahun më të madh në idhujtari, duke adhuruar të tjerë në vend të Allahut.

Në ditët e sotme, mbi Dhomën e Nderuar, gjejmë një Kube të Gjelbër të dallueshme, që tregon se poshtë saj është ajo (Dhoma). Kubeja u pikturua me ngjyrë të gjelbër në vitin 1253 hixhri.

Selami (përshëndetja) për Profetin

(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Është e pëlqyer për këdo që ndodhet në Medine ta vizitojë varrin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe ta përshëndesë atë.

Shkuarja në Dhomën e Nderuar për të përshëndetur Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) nuk kërkon rezervim paraprak përmes aplikacioneve.

Përshkrimi i vizitës së varrit

të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Vizitori hyn nga porta “Selam” në pjesën e përparme të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në lindje, dhe ecën me qetësi dhe dinjitet. Kur arrin përballë Dhomës së Profetit, në vendin e varrit të tij të nderuar (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), vizitori e përshëndet

Profetin fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), duke thënë: *“Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguari i Allahut!”* Pastaj lutet për Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Në lutjen e tij mund të shtojë, duke thënë p.sh.: *“Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut; paqja qoftë mbi ty, o krijesa më e mirë e Allahut; paqja qoftë mbi ty, o më i miri i të dërguarve dhe prijësi i të devotshmëve! Dëshmoj se ti e komunikove Mesazhin, e përmbushe amanetin, e këshillove ymetin dhe luftove për hir të Allahut ashtu siç duhet.*

All-llâhum-me sal-li alâ Muhammedin ue alâ âli Muhammedin kemâ sal-lejte alâ Ibrâhîme ue alâ âli Ibrâhîme, in-neke hamîdun Mexhîd. All-llâhum-me bârik alâ Muhammedin ue alâ âli Muhammedin, kemâ bârrakte alâ Ibrâhîme ue alâ âli Ibrâhîme, in-neke hamîdun Mexhîd.

(O Allah, lavdëroje (tek melekët e lartë) Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar! O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar!) ”

Pastaj bën një hap përpara dhe e përshëndet Ebu Bekër es-Siddikun. Pastaj bën një hap përpara dhe e përshëndet Umer bnu el Hattabin.

Vizitori duhet të qëndrojë me respekt dhe edukatë, dhe të mos ngrejë zërin. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është i gjithmonë i nderuar, qoftë i gjallë apo i vdekur.

Allahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَرْفَعُوا أَصْوَاتَكُمْ فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ
كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ لِبَعْضٍ أَن تَحْبَطَ أَعْمَالُكُمْ وَأَنتُمْ لَا تَشْعُرُونَ إِنَّ الَّذِينَ يَعْضُونَ
أَصْوَاتَهُمْ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ أُولَئِكَ الَّذِينَ امْتَحَنَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ لِلتَّقْوَى لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ
عَظِيمٌ

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare. Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh.”

Kur e përshëndet Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), qëndron sa më afër, përballë varrit të tij. Vizitori qëndron një kohë të shkurtër për ta përshëndetur, me qëllim që t'u japë mundësinë të tjerëve ta përshëndesin edhe ata. Ai largohet me kujdes, në mënyrë që në atë vend të mos bëhet zhurmë dhe kallaballëk.

Mos e fërkoni varrin ose diçka tjetër rreth tij. Nuk i kërkohet Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) plotësimi i dëshirave, as largimi i brengave apo shërimi i të sëmurëve, sepse, të gjitha këto, i kërkohen vetëm Allahut të Plotfuqishëm, të Gjallit e të Përjetshmit, i Cili nuk vdes kurrë. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) erdhi për të rrënjosur besimin e pastër monoteist dhe për të çrrënjosur politeizmin.

Pastaj vizitori del nga Xhamia në mënyrën që hyri: me qetësi dhe dinjitet, për t'u lënë vend muslimanëve të tjerë që vijnë pas tij, të cilët gjithashtu duan të përshëndesin të Dërguarin tonë fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Kopshti i Nderuar (Er-Reudatu esh-Sherifetu)

Kopshti i Nderuar (Er-Reudatu esh-Sherifetu) është pjesë e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ai ndodhet në pjesën e përparme të Xhamisë dhe shtrihet nga Shtëpia e të Dërguarit të Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) - Dhoma e Nderuar (el Huxhratu esh-Sherife) - deri në minberin e tij.

Kopshti i Nderuar (Er-Reudatu esh-Sherifetu) është një vend me vlerë dhe ndikim të madh në shpirt. Atje zbresin mëshira dhe begatitë. Është vendi ku i Dërguari (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe shokët e tij faleshin, luteshin dhe e përmendnin Allahun në çdo gjendje dhe rrethanë. Është pjesa më e mirë e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Ndërmjet shtëpisë sime dhe minberit tim është një prej kopshteve të Xhenetit.”*

Si mund të jetë Kopshti i Nderuar një prej kopshteve e Xhenetit?

Dijetarët e hadithit thonë se ky vend është i ngjashëm me kopshtet e Xhenetit në arritjen e lumturisë dhe qetësisë, për ata që ulen në të. Gjithashtu është thënë se adhurimi apo namazi në të është shkak që të shpie në kopshtin e Xhenetit.

Si të falem në Kopshtin e Nderuar?

Për shkak të numrit të madh të njerëzve që dëshirojnë të falen në Kopshtin e Nderuar dhe për të lehtësuar turmën, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për zgjidhjen e këtij problemi, derisa kjo u arrit të realizohej përmes rezervimit. Kështu që kush dëshiron të vizitojë Kopshtin e Nderuar, bën rezervimin nëpërmjet aplikacioneve zyrtare elektronike. Nëpërmjet këtyre aplikacioneve, vizitorit i përcaktohet koha dhe vendi i hyrjes në Kopshtin e Nderuar.

Këshilla për ju që hyni në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Në shumicën e dyerve, hyrja mund të realizohet nëpërmjet karrigeve të lëvizshme (me rrota).

Karriget portative për të moshuarit dhe për ata që kanë nevojë janë të disponueshme pranë portave kryesore brenda Xhamisë.

Kur hyni në Xhami, mund t'i vendosni këpucët te dera në vendet e caktuara ose në kutitë e shpërndara brenda saj.

Mbani mend numrin e kutisë dhe mos e harroni, sepse vendet janë të ngjashme.

Ju lutemi! Mos i vendosni këpucët tuaja në një vend tjetër përveç vendit të caktuar për to.

Zakonisht të hënën dhe të enjten brenda Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka sofra të iftarit për agjëruesit.

I gjithë uji i disponueshëm për pije në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është nga pusi i Zemzemit. Ky ujë transportohet në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) me standardet më të larta të sigurisë dhe pastërtisë.

Mos harroni se ky është një vend ku Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe shokët e tij të nderuar kanë ecur duke adhuruar dhe e përmendur Allahun në çdo gjendje e në çdo rrethanë. Varri i i nderuar i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është afër jush. Prandaj shfrytëzoheni mirë kohën tuaj për gjëra të dobishme. Kujdes! Mos e ngrini zërin, mos qeshni me zë të lartë dhe

mos e harxhoni kohën tuaj, duke parë në ekranin e celularit gjëra të padobishme.

Brenda Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) janë përhapur shumë klasat (ku nxënësit ulen në formë rrethi) për leximin dhe memorizimin e Kuranit, ku japin mësim mësues të specializuar.

Në rast ju bie se diçka mbi tapetin e Xhamisë ose mbi mermerin e saj duke shkaktuar ndotje, kërkoni menjëherë ndihmën e pastruesit, për ta larguar ndotjen dhe papastërtinë.

Korridoret brenda Xhamisë janë të destinuara për ecje dhe lëvizje. Falja e namazit në to shkakton kallaballëk dhe pengon lëvizjen dhe qarkullimin.

Në oborret e jashtme të Xhamisë ka abdesana, që ua kursejnë besimtarëve vështirësitë e shkuarjes në tualetet e jashtme.

Bëni kujdes, që të mos rrëshqisni në oborret e Xhamisë. Përpiquni të shmangni llojet e këpucëve që shkaktojnë rrëshqitje.

Ndalohet pirja e duhanit në oborret e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Kini kujdes që të mos dilni para imamit gjatë namazit në oborrin jugor të Xhamisë. Përmes tabelave orientuese të vendosura në oborr, ju mund të mësoni udhëzimet për

rreshtimin pas imamit, në mënyrë që të mos rreshtoheni para tij.

Të gjitha portat e Xhamisë janë të shënuara me numra që duken qartë pranë secilës derë. Ju mund të arrini te porta që dëshironi duke ditur numrin e saj.

Për dyert e oborreve të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka numra të posaçëm, të cilat vendosen në portat e murit të jashtëm të oborreve. Këto janë të ndryshëm nga numrat e portave të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Në rast se keni nevojë për vizitë mjekësore, dini se ka dy qendra shëndetësore në periferi të oborreve të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Në oborret e Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) janë 3 qendra të Gjysmëhënës së Kuqe për t'ju ndihmuar rastet emergjente.

Në Kopshtin e Nderuar mund të hyhet nga dy porta (nr. 25 dhe nr. 29) të faltores së grave në anën lindore.

Tualetet për gratë janë të disponueshme në të gjitha pjesët e Haremit - Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), afër zonave ku ato falen. Tualetet kanë një shenjë të qartë për gratë; ato janë:

- Në veri të Xhamisë: nr. 11 B, nr. 9 dhe nr. 12 A.
- Në lindje të Xhamisë: nr. 13 A.

- Në perëndim të Xhamisë: nr. 7 A dhe nr. 7 B.

Varreza e Bekies

Varreza “Bekia” e Medinës Profetike është nga koha e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e deri më sot. Përgjatë shekujve në të janë varrosur shumë njerëz të shquar, në mesin e të cilëve dhe disa nga nënat e besimtarëve (gratë e Profetit - Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe një numër i madh i sahabëve të nderuar (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Bekia ndodhet në juglindje të Xhamisë së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 180 000 m². Quhej “Bekia”, sepse dikur në të kishte shumë pemë; el Bekiu quhet një vend i gjerë me varietete pemësh të larmishme. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i vizitonte shpesh njerëzit e varrosur në Bekie dhe lutej për ta.

Burrat mund të vizitojnë varrezën e Bekies pas namazit të sabahut deri në orën 9 të mëngjesit dhe pas namazit të ikindisë për një orë e gjysmë.

KAPITULLI III

IHRAMI SI HAPI I PARË NË UDHËTIMIN TUAJ TË BESIMIT

Hyrje

Ihrami është hapi i parë në udhëtimin tuaj të besimit. Është një vepër e zemrës, me të cilën vizitori i Qabes hyn në një adhurim të madh. Allahu na urdhëroi të jemi të singertë në qëllimet tona dhe të gjitha veprat t'i bëjmë për të fituar kënaqësinë e Tij, i Lartësuar qoftë Ai, siç ka thënë i Lartësuari:

وَأْتَمُوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ

“Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut!”

Në këtë udhëzues ndërgjegjësimi, do të mësoni gjithçka që ju nevojitet kur të hyni në gjendjen e ihramit.

Çfarë është ihrami?

1. Ihrami është hyrja në adhurimin e haxhit ose umres. Kështu që ai thjesht bën nijet (e vendos me zemër dhe e shpreh me fjalë) për të nisur kryerjen e adhurimit të umres, duke e filluar me telbije (formula e dhikrit që thuhet me zë në gjendjen e ihramit).
2. Përmes telbijes ai deklaron hyrjen në adhurimin e umres ose haxhit, duke thënë: **“Lebejke umratën”** (O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde për të kryer umren.)
3. Është sunet (e pëlqyer) të lahet ose të marrë abdes para se të hyjë në gjendjen e ihramit.

4. Sapo bën nijetin, ai fillon menjëherë ritualet e umres; ndërkaq, bën kujdes (distancohet) nga çdo gjë që nuk i lejohet në gjendjen e ihramit.

Veshja e ihramit

Ihrami është një rrobë e posaçme, e përbërë nga dy pjesë: izari, me të cilin mbështjell pjesën e poshtme të trupit dhe ridaja, me të cilën mbulon pjesën e sipërme të tij; normalisht, ihrami duhet të jetë e bardhë.

Haxhiu mund të përdorë rrip, që mbështillet rreth belit për të mbajtur izarin që të mos bjerë; si dhe për të mbajtur në të celularin dhe paratë.

Të gjithë njerëzit janë të barabartë në veshjen dhe pamjen e tyre; ata nuk dallohen nga ngjyrat apo gjërat materiale; ata qëndrojnë në të njëjtin vend, duke e lutur Allahun me përgjërime e përvuilësi.

Ihrami i grave është çfarëdo veshje që ato dëshirojnë, me kusht që këto rroba të jenë:

1. Të gjera e të lirshme, që mbulojnë trupin e gruas dhe nuk e pengojnë lëvizjen e saj.
2. Nuk duhet të jenë e zbukuruara, që (gruaja) mos i tërheqë burrat me veshjen e saj.

Parakushti

Nëse vizitori i Qabes ka frikë se nuk do të mund t'i kryejë ritualet deri në fund, për shkak të ndonjë sëmundjeje apo kur është i justifikuar nga sheriat, apo për arsye që janë jashtë dëshirës e vullnetit të tij, atëherë, në të tilla raste, atij i lejohet të vendosë një parakusht. Vepron në këtë mënyrë: pas fjalëve **“Lebejke umratën”** (O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde për të kryer umren) thotë:

“Fe in habeseni habisun, fe mehali hajthu habesetni”

(Nëse më del ndonjë pengesë që ma pamundëson vazhdimin e ritualeve, atëherë vendi im është aty ku më doli kjo pengesë - pra, do t'i ndërpres ritualet e umres). Këto fjalë i thotë në gjuhën që preferon.

Teksa i thotë këto fjalë dhe vendos këtë parakusht, nëse i del ndonjë pengesë që ia pamundëson kryerjen e ritualeve, atëhere atij i lejohet të lirohet nga ihrami dhe nuk detyrohet për asgjë (kur i ndërpret ritualet e umres në të tilla rrethana, nuk bie në mëkat).

Telbija

Telbija është dhikri i mëposhtëm:

لبيك اللهم لبيك لبيك لا شريك لك لبيك إن الحمد والنعمة لك والملك لا شريك لك

**Leb-bejkell-llâhum-me, leb-bejk! Leb-bejke, lâ sherîke
leke leb-bejk! In-nel hamde, uen-ni'mete, leke uel mulk.
Lâ sherîke lek**

*(O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde, i dorëzohem vendimit
Tënd dhe respektoj urdhërin Tënd, herë pas here. Kështu kam
për të vazhduar gjithmonë. Ti nuk ke shok. Vërtet, lavdia dhe
pushteti të përkasin vetëm Ty. Mirësitë i jep vetëm Ti. Ti nuk ke
shok.)*

Kuptimi i telbijes: O Zoti ynë, ne erdhëm, duke iu
përgjigjur thirrjes Tënde, për të kryer umren herë pas here,
duke besuar se Ti je Një e i Vetëm; dhe vetëm Ti e meriton
adhurimin, si dhe duke pranuar e dëshmuar mirësitë e
begatitë e Tua dhe përsosmërinë e pushtetit e sundimit
Tënd.

Telbija është motoja madhështore e vizitorëve të
Qabesë, përmes së cilës ata deklarojnë së janë robër të
bindur e të përkushtuar ndaj Allahut, Krijuesit të
Lartësuar, Dhuruesit të Begatë.

Burrat bëjnë telbije më zë të lartë, ndërsa gratë e thonë
me vete.

Telbija fillon me veshjen e ihrami. Ajo (telbija)
përfundon: kur vizitori i Qabes shikon Shtëpinë e Shenjtë
(Qabenë).

Mikadet

Në nderim të Shtëpisë së Shenjtë të Allahut, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) përcaktoi vendet përpara Mekës nga të cilat veshin ihramin ata që vijnë në Mekë për haxh apo umre; nga mikadet ata fillojnë të bëjnë telbije para se të arrijnë në Tokën e Shenjtë.

Këto vende ndryshojnë sipas destinacionit të mbërritjes. Vizitori Qabes që jeton larg Mekës është i obliguar ta veshë ihramin në këto mikate ose në drejtim të tyre, kur udhëton në rrugë tokësore; ndërsa në rast se udhëton me avion, e vesh ihramin kur kalon mbi mikat. Atij nuk i lejohet ta kalojë mikatin pa veshur ihramin, pa bërë nijetin për kryerjen e umres. Zakonisht, aeroplanët që vijnë në Xhide, para së t'i afrohen mikatit, i njoftojnë vizitorët e Qabes, në mënyrë ata të veshin ihramin, të bëjnë nijetin për kryerjen e umres.

Njerëzit që veshin ihramin, për të filluar ritualet, janë tre kategori:

1. Ata që gjenden në Mekë:

Ata që duan të kryejnë umren, e veshin ihramin nga vendi më i afërt jashtë Haremit (jashtë kufijve të Tokës së Shenjtë), siç është xhamia e Nënës së Besimtarëve, Aishes në Teni'm.

2. Ata që ndodhen ndërmjet Mekës dhe mikateve: E veshin ihramin dhe fillojnë ritualet e umres nga vendi i tyre.

3. Ata që ndodhen pas mikateve: Duhet të veshin ihramin dhe të bëjnë nijetin për kryerjen e ritualeve të umres nga mikatet apo kur kalojnë në drejtim të tyre (mikateve).

Mikatet janë pesë:

1. Dhul Hulejfe
2. El Xhuhfe
3. Karnu el Menazil
4. Jelemlem
5. Dhatu Irk

Çfarë nuk lejohet në gjendjen e ihramit?

Ndalimet e përgjithshme (për burrat dhe gratë):

1. Marrëdhëniet seksuale.
2. Kontrata martesore.
3. Gjuetia e kafshëve tokësore.
4. Rruajtja e kokës dhe prerja e thonjve.
5. Përdorimi i parfumit.

Ndalimet për burrat:

1. Mbulimi e kokës.
2. Veshja e rrobave të qepura.

Ndalimi i veçantë për grate: Mbulimi i fytyrës

Nuk janë prej gjërave që ndalohen në gjendjen e ihramit:

1. Larja.
2. Mbajtja e syzeve, unazës dhe ores.
3. Fashimi i plagës.
4. Vendosja e rripit dhe çantës së parave rreth trupit.
5. Veshja e këpucëve.
6. Mbajtja ombrellës.

Gruaja mund ta mbulojë fytyrën, kur druhet nga ndonjë sprovë.

Për parandalimin e disekzioneve dhe inflamacionit të lëkurës pas veshjes së ihramit:

Problemi i disekzioneve dhe inflamacionit të lëkurës tek vizitorët e Qabes është evident dhe i përhapur, veçanërisht tek obezët ose diabetikët. Atyre u infektohet lëkura dhe u skuqen kofshët nga inflamacioni, ndonjëherë skuqja

shfaqet edhe në sjetull ose nën gj; kjo shoqërohet me kruajtje të bezdisshme, ndoshta edhe të dhimbshme.

Mënyrat e parandandalimit

1. Ajrosni mirë pjesën e sipërme të kofshëve dhe zonës së sjetullës.
2. Kushtojini vëmendje higjenës personale dhe përdorni pomada në trup përpara se të ecni.
3. Kur infektoheni, përdorni kremra medicinale dhe lani mirë zonën përpara se të vendosni ilaçin.

Rregullat e mirësjelljes muhrrimit (besimtarit në gjendjen e ihramit)

Që nga momenti kur vizitori i Qabes vesh ihramin ai është në adhurim të madh. Prandaj, ai duhet të kujdeset për fjalët, veprimet dhe sjelljet e tij, që të fitojë shpërblime të mëdha, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

الحج أشهر معلومات فمن فرض فيهن الحج فلا رفث ولا فسوق ولا جدال في الحج وما تفعلوا من خير يعلمه الله وتزودوا فإن خير الزاد التقوى واتقون يا أولي الألباب

“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë

është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”

Këshilla dhe paralajmërime të përgjithshme:

1. Duhet ta ripërtërinin njetin (qëllimin) dhe përkushtimin tuaj ndaj Allahut të Lartësuar. Vizita e Qabes tregon për dashurinë tuaj ndaj Allahut dhe bindjen e respektin ndaj urdhrit të Tij, duke shpresuar në mëshirën dhe shpërblimin e Tij, si dhe nga frika prej dënimit të Tij. Ti nuk e kryen umren për hipokrizi dhe as të tregosh arrogancë e mendjemadhësi. Teksa të tjerët do të thonë: “Filani vizitoi Qabenë.”, ti je i vetëdijshtëm se nuk ke kryer këtë adhurim që të quresh “Vizitor i Qabesë”.

2. Përpiquni që t'i mësoni rregullat e umres dhe të pyesni njerëzit e ditur, për çështjet që nuk i dini apo i keni të paqarta. Sigurisht që në këtë udhëzues ju do të gjeni gjithçka të dobishme, që ju nevojiten gjatë gjithë kohës të këtij udhëtimit të besimit.

3. Sjellja e mirë me njerëzit në përgjithësi dhe me shokët e udhëtimit në veçanti është shumë e rëndësishme. Kjo realizohet duke i përshëndetur ata dhe duke iu buzëqeshur, duke shmangur grindjet e polemikat, si dhe duke i ndihmuar të plotësojnë nevojat e tyre.

4. Jini të qetë dhe të butë gjatë ballafaqimit me situata të ndryshme, siç ka thënë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *“Allahu është i Butë dhe e do butësinë. Përmes*

butësisë Ai jep atë që nuk e jep përmes vrazhdësisë; dhe nuk e jep nëpërmjet asnjë gjëje tjetër veç saj (butësisë)."

5. Ndiqni udhëzimet e organizatorëve dhe udhëzimet e përgjegjësve të agjencisë tuaj të të umres, për të siguruar një udhëtim të qetë dhe për të mos dëmtuar të tjerët.

KAPITULLI VI

UDHËZUES

PËR KRYERJEN E RITEVE TË UMRES

Umra

Umra është një prej veprave dhe adhurimeve më të mira që i do Allahu, teksa besimtari e drejton zemrën, gjuhën dhe gjymtyrët drejt Shtëpisë së Allahut, duke kërkuar mëshirën dhe kënaqësinë e Tij.

Në këtë udhëzues, do të njiheni me informacionet, udhëzimet dhe orientimet më të rëndësishme, që ju nevojiten në udhëtimin tuaj drejt Shtëpisë së Shenjtë.

Vlerat e umres

Umra ka shumë vlera, ndërmjet të cilave:

- Umra e pastron njeriun nga gjynahet dhe e zbut varfërinë: Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kryeni haxhin dhe umren në mënyrë të vazhdueshme, sepse ato eliminojnë varfërinë dhe mëkatet ashtu sikurse i largon farkëtimi skorjet e hekurit.”*
- Përsëritja e umres i shlyen mëkatet mes tyre: Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kryerja e umres i shlyen gjynahet që janë bërë ndërmjet saj dhe të mëparshmes (umres që është kryer më parë).”*

Umra me pak fjalë

Umra është formë adhurimi ndaj Allahut, përmes ihramit (me veshjen e të cilit bëhet edhe nijeti, fillon umreja), tauafit në Shtëpinë e Shenjtë dhe sajit ndërmjet Safasë dhe Meruasë, si dhe duke e rruar ose shkurtuar flokët.

1. Muslimani e vesh ihramin nga vendi që ia ka caktuar sheriatit dhe ruhet nga çdo gjë që ia ndalon gjendja e ihramit.

2. Bën telbije duke thënë:

لبيك اللهم لبيك لبيك لا شريك لك لبيك إن الحمد والنعمة لك والملك لا شريك لك

Leb-bejkell-llâhum-me, leb-bejk! Leb-bejke, lâ sherîke leke leb-bejk! In-nel hamde, uen-ni' mete, leke uel mulk. Lâ sherîke lek

(O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde, i dorëzohem vendimit Tënd dhe respektoj urdhërin Tënd, herë pas here. Kështu kam për të vazhduar gjithmonë. Ti nuk ke shok. Vërtet, lavdia dhe pushteti të përkasin vetëm Ty. Mirësitë i jep vetëm Ti. Ti nuk ke shok.)

3. Besimtari shkon në Harem dhe sillet rrotull Qabes shtatë herë, duke e pasur atë (Qaben) në të majtën e tij. E fillon tauafin nga Guri i Zi dhe e përfundon gjithashtu atje (te Guri i Zi).

4. I fal dy rekate pas përfundimit të tauafit.

5. Pastaj drejtohet për në kodrën Safa, ku dhe fillon sajin (ecjen e shpejtë) drejt kodrës Merua. Kur arrin në Merua, ai ka plotësuar një *sheut* (ecja nga Safa në Merua), pastaj kthehet në Safa për të dytin (nga Meruaja në Safa) dhe kështu me radhë, derisa e përfundon të shtatin në Merua.

6. Burri rruan ose pret flokët, ndërsa gruaja i mbledh flokët dhe i pret nga majat sa një majë gishti (1-2 cm). Kështu përfundon umreja dhe lirohet nga ihrami.

Tauafi

Tauafi është një adhurim ndaj Allahut, në të cilin muslimani sillet rrotull Shtëpisë së Shenjtë (Qabes), duke adhuruar të Lartësuarin dhe duke iu afruar Atij sipas asaj që ka urdhëruar.

Fillimi dhe fundi i tauafit:

- Vizitori i Qabes e fillon tauafin nga cepi (këndi) ku ndodhet Guri i Zi. Atje ka një shenjë jeshile, që tregon fillimin e mbarimin e tauafit. Këtë shenjë e shohin edhe ata që e bëjnë tauafin në katet e sipërme.
- Vizitori i Qabes duhet të thotë tekbirin në fillim të tauafit dhe sa herë që kalon në drejtim të Gurit të Zi gjatë rrotullimit përreth Qabes. Nuk është kusht që tekbiri të thuhet në një pikë të caktuar. Vendi ku bëhet tekbiri caktohet me afërsi. E rëndësishme është që vizitori i Qabes

të jetë afërsisht në drejtim të Gurit të Zi në momentin kur thotë tekbirin.

- Ai thotë tekbirin dhe bën shenjë me dorë kah Gurit të Zi; pastaj fillon të sillet rrotull Qabes, në mënyrë që ajo të jetë në të majtë të tij (në drejtim të kundërt të akrepave të orës). Puthja e Gurit të Zi është sunet (vepër e pëlqyer) për ata që e kanë të lehtë, por kjo gjë tashmë është bërë e vështirë, sepse kallaballëku është i madh.
- Vizitori i Qabes vazhdon tauafin, duke iu lutur Allahut me përgjërime e përrulësi.
- Kur arrijnë në këndin që i paraprin Gurit të Zi, i cili quhet Këndi i Jemenit, është e pëlqyeshme ta prekësh me dorë, nëse e ka mundësinë. Mirëpo, kjo gjë tashmë është bërë e vështirë.
- Pastaj e përfundon rrotullimin në drejtim të Gurit të Zi, pikërisht te vendi ku e filloi. Këtu bën shenjë me dorë dhe thotë tekbirin. Në këtë mënyrë ka përfunduar një rrotullim të plotë.
- Ai e përsërit këtë 7 herë, pra, sillet shtatë herë rrotull Qabes.

Këshilla të përgjithshme gjatë tauafit:

- Qëndrimi në zonën ku bëhet tauafi shkakton kallaballëk dhe rrëmujë.

- Nuk lejohet që vizitori i Qabes të lëvizë në drejtim të kundërt të tauafit për çfarëdolloj arsye që mund të ketë.
- Shmangni vendet ku ka rrëmujë e kallaballëk.

Prej suneteve të tauafit për burrat janë:

- *El Idtibau* - veshja e ridasë (pjesës së sipërme të ihramit) në mënyrë të atillë që vizitori i Qabes të nxjerrë shpatullën e djathtë, duke ndjekur shembullin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).
- *Er-Ramelu* - ecja e shpejtë me hapa të vegjël e të shpeshtë (jo duke vrapuar). Kjo bëhet në tre rrotullimet e para të tauafit, nëse është e mundur (pa i dëmtuar haxhinjtë). Ndërsa katër rrotullimet e tjera bëhen me ecje normale.
- Lutja e veçantë ndërmjet Këndit të Jemenit dhe Gurit të Zi: Vizitori i Qabes lutet shumë, duke i kërkuar Allahut gjëra të rëndësishme për të cilat ka shumë nevojë. Është sunet (e pëlqyer) që në fund të rrotullimit, midis Këndit të Jemenit dhe Gurit të Zi, të thotë:

ربنا آتنا في الدنيا حسنة وفي الآخرة حسنة وقنا عذاب النار

“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!”

- Dy rekatet e tauafit: Vizitori i Qabes kur përfundon shtatë rrotullimet e tauafit, duhet ta mbulojë shpatullën.

Pastaj është sunet që të falë dy rekate të shkurtra pas Mekamit të Ibrahimit në vendin e caktuar nga autoritetet përgjegjëse. Nëse nuk mundet atje, le të falet kudo në Harem.

Vendi i dy rekateve të tauafit:

- Haxhiu i fal dy rekatet kudo në Harem, sipas organizimit që kanë bërë forcat e sigurisë në atë kohë.
- Nëse është e lehtë për të që Mekamin e Ibrahimit ta ketë përpara, kur falet, qoftë edhe nga një vend i largët, le ta dije se kjo është e pëlqyeshme, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

وَاتَّخِذُوا مِنْ مَّقَامِ إِبْرَاهِيمَ مُصَلِّينَ

“Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend faljeje!”

- Kujdes! Mos lëndoni besimtarët dhe mos ua vështirësoni kryerjen e tauafit, sepse besimtari që bën tauaf rreth Qabes është parësor dhe ka më shumë të drejtë se të tjerët për ta përdorur atë vend. Allahu i Lartësuar i ka dhënë përparësi në Librin e Tij:

أَنْ طَهَّرَا بَيْتِي لِلطَّائِفِينَ وَالْقَائِمِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ

“Pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur.”

- Është sunet leximi i sures el Kafirun në rekatën e parë dhe i sures el Ihlas në të dytin.

Pasi mbaroi tauafin, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) piu ujë zemzemi. Është sunet ta ndiqni atë (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), duke vepruar në këtë mënyrë. Në kohën tonë kjo është gjë e lehtë. Duke shkuar për të kryer sajën, gjatë rrugës do të gjeni shumë çezma e termusë, ku mbahet i ftohtë uji i Zemzemit, të cilët, në fakt, janë shpërndarë në të gjithë Haremin.

Saji

Shkuarja në vendin ku bëhet saji: ndërmjet dy kodrave Safa dhe Merua)

Kur të përfundoni tauafin, do të gjeni brenda Xhamisë së Shenjtë tabela udhëzuese, që ju orientojnë drejt vendit ku bëhet saji. Ato ju tregojnë Safanë, prej ku fillon ky ritual i umres.

Ju këshillojmë që, pasi të keni përfunduar tauafin rreth Qabes, të shkoni në katet e sipërme të vendit ku bëhet saji:

- Për të shmangur grumbullimin në katin e poshtëm.
- Për t'ia lehtësuar vetes dhe vëllezërve tuaj muslimanë.

Për të shkuar në katet e sipërme të vendit ku bëhet saji:
Drejtohuni te hyrjet e shkallëve elektrike (ju mund t'u
kërkoni ndihmë rojeve të sigurisë që t'ju orientojnë).

Safa dhe Merua

Janë dy kodra të vogla mbi të cilat u ngjit Haxhireja
(nëna e Ismailit - Paqja e Allahut qoftë mbi të!), në kërkim
të ushqimit ose ujit.

Safa:

- Është një kodër e vogël nga ku fillon saji.
- Shkëmbinjtë malorë janë ende të dukshëm në katin e poshtëm të vendit ku bëhet saji.

Merua:

- Është një kodër vogël ku përfundon saji.
- Te kjo kodër vizitori i Qabes e përfundon sajnin.

Saji ndërmjet Safasë dhe Meruasë është një nga ritualet e haxhit dhe umres. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ

“Kodrinat Safa dhe Merua (në Mekë) janë pjesë e Simboleve të Allahut.”

Përshkrimi i sajit

Vizitori i Qabes e adhuron Allahun duke kaluar përshkuar 7 herë distancën ndërmjet Safasë dhe Meruasë, siç bëri i Dërguari i Tij fisnik (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Saji fillon nga Safaja dhe përfundon në Merua.

- Përshikimi i distancës nga Safaja në Merua konsiderohet një e shtata e sajit.
- Përshikimi i distancës nga Merua në Safa, konsiderohet një e shtata e dytë e sajit, e kështu me radhë, derisa plotësohen shtatë.

Dy shenjat (dritat) e gjelbra:

Është e pëqyeshme që burrat e aftë të vrapojnë mes dy shenjave (dritave) të gjelbra, siç bëri Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Lutjet gjatë kryerjes së sajit:

Kur bën sajin, besimtari duhet ta mbushë gjithë kohën me dhikër (ta përmendë Allahun shumë), lutje dhe të lexojë Kuran.

Lutja në fillim të Safasë dhe Meruasë:

Kur arrin në fillimin e Safasë ose Meruasë, është e pëlqyer që besimtari të ngrejë duart, të drejtohet kah Kibles, t'i lutet Allahut dhe të bëjë tekbir përpara se të fillojë ecjen e shpejtë ndërmjet tyre (dy kodrave).

Lutja e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): Kur Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u afrua te Safaja, lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar:

إن الصفا والمروة من شعائر الله

“Safa dhe Merua janë, pa dyshim, nga shenjat e qarta të fesë së Allahut.” Pastaj tha: *“Po e filloj me atë që e ka filluar edhe Allahu.”*

Kësisoj ai filloi me Safanë, u ngjit mbi kodrinë, nga ku dukej Qabeja, u kthye drejt saj, njësonte Allahun, dhe tha:

All-llâhu ekberr, All-llâhu ekberr, All-llâhu ekberr. Lâ ilâhe il-lalllâhu uahdehu lâ sherîke leh. Lehul mulku ue lehul hamdu ue hue alâ kul-li shej'in kadîr. Lâ ilâhe il-lalllâhu uahdehu, enxheze ua'dehu, ue nesarra abdehu, ue hezemel ahzâbe uahdehu!

(Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi. Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Allahut, Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. Atij i takon sundimi dhe lavdia, dhe Ai është i Plotpushtetshëm për gjithçka. Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Allahut. Ai e përmbushi premtimin e Tij, i dhuroi fitoren robit të Tij dhe i mposhti ushtritë e Vetëm).

Këtë dhikër e përsëriti tri herë dhe ndërmjet këtyre herëve bënte lutje. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) veproi edhe mbi Merua, ashtu siç veproi mbi Safa. Pastaj vazhdonte sajën.

Besimtari që kryen sajën nuk duhet të ndalet për t'u lutur në një vend ku pengon trafikun dhe shkakton rrëmujë. Ai duhet t'u përmbahet udhëzimeve të punonjësve të policisë dhe forcave përgjegjëse për ruajtjen e rendit në Harem.

Saji në gjuhën e shifrave:

Gjatësia e zonës ku bëhet saji është 394 m.

Distanca mesatare që përshkuan besimtari gjatë gjithë sajit është 2761.5 m.

Shpejtësia e ecjes ndryshon nga një person tek tjetri. Ajo varet nga disa faktorë, si: vazhdimësia, pengesat, kallaballëku dhe koha e lutjes, si dhe nga faktorë që kanë të bëjnë me vetë besimtarin që kryen sajën (mosha, pesha etj.)

Koha mesatare për të përfunduar sajën është 45 -55 minuta.

Përsëritja e umres

Për ata që kanë mundësi, është e pëlqyeshme ta kryejnë umren herë pas here. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kryerja e umres i shlyen gjynahet që janë bërë ndërmjet saj dhe të mëparshmes (umres që është kryer më parë).”*

Përsëritja e umres në të njëjtin udhëtim nuk ka qenë e njohur te sahabët, përveçse për ndonjë arsye të fortë. Pas umres, ata kryenin shumë adhurime, si p.sh. lexonin Kuran apo falin namaz, dhe kjo i lehtësonte haxhinjtë dhe vizitorët e Qabes.


Gjithsesi, lejohet përsëritja e umres në të njëjtin udhëtim, qoftë për vete apo për të tjerët, por me kusht që kjo të mos i ngushtojë vizitorët e Qabes.

Kushdo që dëshiron të bëjë umren, duhet të marrë leje në aplikacionet zyrtare, për ta kryer në kohën që i caktohet.

Ai që dëshiron të kryejë umren dhe merr lejen zyrtare për të, duhet të dalë nga kufijtë e Haremit, për të veshur ihramin (e për të bërë nijetin) prej andej. Kështu p.sh. mund të shkojë në Teneim, në xhaminë e Aishes (Allahu

qoftë i kënaqur me të!), dhe prej andej bën nijetin për umre.

Më mirë bëni vetëm një umre, pasi kallaballëku është i madh, dijeni se kështu ju ndihmoni në pakësimin e rrëmujës dhe u jepni mundësi vizitorëve të tjerë Qabes, të cilët nuk kanë qenë në gjendje të kryenin umren, ta kryejnë atë (umren) me qetësi dhe në kushte të përshtatshme.



KAPITULLI V

TË NJOHIM MEKËN
KRYEQYTETIN E SHENJTË

Në këtë udhëzues, do të mësoni informacionet dhe udhëzimet më të rëndësishme për një vizitë të veçantë në Mekën e Nderuar.

Vlerat e mirësitë e Mekës

Meka e Nderuar është vendi më i mirë dhe më i dashur për Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Allahu e zgjodhi atë për ritualet e haxhit dhe e bëri vizitën e Qabes adhurim, përmes të cilit Allahu ia shlyen gjynahet besimtarit dhe e lartëson në Xhenet. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Për Allahun, ti je vendi më i mirë i Allahut, ti je vendi më i dashur i Allahut tek Allahu!”*

Meka është vendi ku u ndërtua Faltorja e parë për adhurimin e Allahut me përkushtim të sinqertë dhe besim të pastër monoteist:

إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ

“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”

Në këtë udhëzues do të mësoni se çfarë duhet të vizitoni dhe çfarë ju ndihmon për të arritur qëllimet tuaja.

Çfarë është Haremi (Vendi i Shenjtë)?

Pse është shenjtëruar ky vend?

Haremi është vendi ku ndalohen disa gjëra, të cilat lejohen në vende të tjera, për të nderuar e madhëruar Ligjvënësin (Allahun e Lartësuar):

ذَٰلِكَ وَمَنْ يُعَظِّمِ حُرْمَاتِ اللَّهِ فَهُوَ خَيْرٌ لَّهُ عِنْدَ رَبِّهِ

“Këto (janë urdhërimet). Për atë që nderon ritet e shenjta të Allahut, do të jetë më mirë te Zoti i tij.”

Allahu e zgjodhi këtë tokë, e dalloi nga vendet e tjera dhe e bëri të shenjtë, duke ndaluar në të gjëra që i ka lejuar në vende të tjera, si dhe e veçoi me mirësi e begati, që nuk gjenden tek të tjerët. Është një shenjtëri që shkon thellë në historinë e gjithë universit; është një ekskluzivitet që ky vend e gëzon qysh nga fillimet e njerëzimit. Allahu e ka shenjtëruar këtë tokë dhe e ka ngritur në një pozitë të lartë që ditën kur krijoi universin që ne njohim; dhe kështu do të mbetet deri në fund të kësaj gjithësie. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Allahu e shenjtëroi këtë vend që ditën kur krijoi qiejt dhe Tokën, kështu që ai do të jetë i shenjtë deri në Ditën e Gjykimit, sepse e shenjtëroi Allahu i Lartësuar.”*

Çfarë do të thotë Harem për mua?

Tashmë ju jeni në një vend që Allahu e veçoi dhe i dha prestigj të lartë, e nderoi dhe i dha mirësi e begati të

mëdha para se të krijonte njerëzit. E urdhëroi Ibrahimin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) të ngrinte themelet dhe të ndërtonte Qabenë përpara se njeriu të jetonte në të, në mënyrë që ajo të jetë Kibla dhe udhërrëfyesja për mbarë botën:

إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ

“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyesja për popujt.”

Jeni në një vend ku shpërblimet e veprave të mira shumëfishohen, ndërsa ligësitë që bëhen këtu nuk janë si e veprimet e këqija që bëhen në vende të tjera.

Allahu i urdhëroi dy krijesat më fisnike të Tij, Ibrahimin dhe Ismailin (Paqja e Allahut qoftë mbi të dy!), dhe më pas krijesën më të mirë të Tij, Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) që ta ndërtonin e ta mirëmbanin Qabenë, ta pastronin e të kujdeseshin për të.

Kufijtë e Haremit

Haremi ka kufij të njohur që Allahu ia mësoi Ibrahimit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe ai ua mësoi njerëzve. Kjo dije u trashëguua brez pas brezi, derisa erdhi Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), i cili i miratoi dhe i sqaroi kufijtë e Haremit.

Ato mund të shihen sot në rrugët që të çojnë në Mekë. Ato kanë largësi të ndryshme nga Qabeja:

- Nga rruga e Medines (Teneim) distanca nga Qabeja është: 6.5 km.
- Nga autostrada e Xhedës: 22 km.
- Nga rruga el-Lejth el Xhedid: 17 km.
- Nga rruga Taif es-Sejl: 12.850 km.
- Nga rruga Taif el Heda: 15.5 km.

Zona e Haremit ka vend shumë të veçantë në sheriatin islam, sepse për ata që hyjnë në këtë zonë ka dispozita specifike; disa prej tyre do t'i mësohesh në këtë udhëzues.

Cilat janë veçoritë e Haremit?

Meka dhe Haremi karakterizohen nga rregulla, dispozita, sjellje dhe vlera që nuk i ka asnjë vend tjetër, ndërmjet të cilave përmendim:

1. Namazet në të janë të barasvlershme me njëqind mijë namaze në vendet e tjera. Kjo përfshin të gjitha xhamitë e Mekës dhe shtëpitë brenda kufijve të Haremit.
2. Jomuslimanët nuk hyjnë në të.
3. Ndalohet gjuetia e kafshëve dhe shpendëve në çfarëdolloj forme.

4. Nuk lejohet prerja e pemëve apo e barit në zonën e Haremit.

5. Njeriu është i sigurt në të; atij i sigurohet jeta e pasuria. Askush nuk mund të vritet apo të dëmtohet në të. Allahu i Lartësuar ka thënë:

ومن دخله كان آمناً

“Kush hyn në të është i sigurt.”

Gjatë sezonit të haxhit, hyrja në Mekë është e organizuar. U ndalohet hyrja atyre që nuk kanë leje për të kryer haxhin, në mënyrë që haxhinjve t’u krijohen kushte të përshtatshme dhe t’u shërbehet sa më mirë.

Qabeja

Qabeja është Kibla e muslimanëve dhe vendi më i dashur i zemrave të tyre; vetëm në Qabe ata sillen rreth e rrotull, duke adhuruar Allahun e Lartësuar.

1. Qabeja ka katër qoshe të emërtuara sipas drejtimeve të tyre:

- Këndi i Jemenit në jug.
- Guri i Zi në lindje.
- Këndi i Shamit në perëndim.
- Këndi i Irakut në veri.

2. *El Hatimu* (Hixhru Ismail): Është një hapësirë në formën e një gjysmërrethi pranë Qabes; një pjesë e tij ka qenë pjesë e Qabes.

3. Dera e Qabesë:

- Ndodhet në anën lindore të saj.
- Gjatësia e derës është 318 cm, ndërsa gjerësia e saj është 171 cm.
- Sot ajo është prej ari të pastër, me peshë 280 kg.

4. *Multezemi*: Është muri lindor ose një pjesë e tij, i cili ndodhet midis Gurit të Zi dhe derës së Qabesë. Riti që kryet në Multezem: Ai që dëshiron të lutet në këtë vend, vendos gjoksin, fytyrën, krahët dhe duart mbi të dhe i lutet Allahut të Lartësuar për çdo gjë që dëshiron. Kjo mund të jetë e vështirë ose e pamundur gjatë periudhës së haxhit dhe kur ka kallaballëk të madh.

4. *Mizabi* (Ulluku): Është ulluku i instaluar në anën veriore të tarracës së Qabesë, për të kulluar ujin. Prej tij uji bie në Hixhër.

6. *Shadhroni* (veshja e pragut përreth Qabesë): Është një strukturë mbështetëse për Qabenë, e cila e rrethon atë si një material mbështjellës. Shadhroni nuk është prej Qabesë, por ai është vendosur për të forcuar ndërtesën e Qabesë dhe për ta mbrojtur atë nga shirat e rrëmbyeshëm. Dhe, në fakt, e ka ruajtur Qabenë ndër vite. Sot atë e gjejmë të mbuluar me mermer të bardhë.

Qabeja nga brenda

Shumë njerëz janë të prirur të dinë se çfarë ka brenda Qabesë. Ja disa informacione që ju interesojnë.

Çelësat e Qabes: Kujdestaria e Qabesë dhe mbajtja e çelësave të saj që nga kohërat e lashta ka qenë në dorë pasardhësve të Ismailit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Para se t'i shpallej Profecia Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kurejshët pas një mosmarrëveshjeje për ndarjen e privilegjeve ndërmjet tyre, ranë dakord që, kujdestaria e Qabesë t'i jepej Uthman bnu Talhës, prijësit të fisit Benu Abdu ed-Dar, gjithashtu ai do t'i mbante edhe çelësat. Pas çlirimit të Mekës, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i mori çelësat e Qabes prej tij, hyri në të, pastaj ia ktheu përsëri dhe lexoi ajetin kuranor:

إن الله يأمركم أن تؤدوا الأمانات إلى أهلها

“Allahu ju urdhëron që amanetet t'jua ktheni atyre që u përkasin (pronarëve të tyre).” Nga ajo kohë dhe deri më sot çelësat e Qabesë janë në dorë të pasardhësve të Uthmanit; për të kujdeset më i moshuari i fisit Benu Abdu ad-Dar.

Shtyllat e Qabes: Brenda Qabesë ka tre shtylla të forta prej druri, që mbajnë çatinë e saj. Për herë të parë ato janë vendosur nga Abdullah bnu ez-Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!); pra, shtyllat janë më shumë se 1350 vjet të vjetra. Ato kanë ngjyrë kafe me tendencë paksa të zezë. Perimetri i secilës shtyllë është afërsisht 150 cm dhe

diametri 44 cm. Baza e çdo shtylle është prej druri të gdhendur në formë katrore. Mes shtyllave janë varur llamba historike.

Dyshemeja dhe muret e Qabes nga brenda: Dyshemeja e Qabes së Shenjtë është prej mermeri, pjesa më e madhe e të cilit është e bardhë dhe pjesa tjetër me ngjyra. Muri i Qabes nga brenda është i stolitur me mermer shumëngjyrësh dhe i zbukuruar me mbishkrime të bukura. Qabeja është e mbuluar nga brenda, ndërsa në tavan ajo ka edhe me një perde mëndafshi mbi të cilën janë shkruar dy dëshmitë (**LA ILAHE IL ALLAH. MUHAMED RESULULLAH.**) me ngjyrë të bardhë dhe disa nga emrat e Allahut.

Shkallët e Qabes: Në të djathtë të pjesës së brendshme të Qabesë është një ndërtesë që rrethon shkallët që të çojnë në çati, e cila ka një derë me një bravë të veçantë dhe një perde të bukur mëndafshi të qëndisur me ar dhe argjend. Shkallët përfundojnë në çati, e cila është e mbuluar me një kapak të papërshkueshëm nga shiu; për t'u ngjitur në çati, duhet të ngrihet kapaku.

Guri i Zi

- Guri i Zi është prej gurëve të Xhenetit, siç na ka treguar Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)
- Nga Guri i Zi fillon tauafi; dhe po tek ai mbaron.

• Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e vendosi Gurin e Zi në vendin e vet kur njerëzit patën mosmarrëveshje ndërmjet tyre se kush do ta vendoste në vendin e tij, pasi një pjesë e ndërtesës së Qabesë ishte rrënuar nga shiu.

Vendodhja e Gurit të Zi:

- Ndodhet në këndin juglindor të Qabes
- Ndodhet në lartësinë 1.5 m nga toka.

Korniza e argjendtë:

- Guri i Zi është i rrethuar nga një kornizë argjendi, për ta mbrojtur.
- I pari që ia vendosi Gurit të Zi kornizën e argjendtë ishte Abdullah bnu ez-Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Prekja dhe puthja e gurit:

- Preferohet puthja e Gurit të Zi, sipas shembullit të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), nëse kjo është e mundur, pa shkaktuar rrëmujë, sidomos në periudhën e haxhit
- Kur e prek Gurin e Zi apo ia bën me shenjë nga larg, e madhëron Allahun (thua: “Allahu Ekber!”).

Muslimani e shmang rrëmujën dhe nuk hyn në turmë për të puthur Gurin e Zi, që të mos dëmtojë veten dhe të tjerët.

Mekami i Ibrahimit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

Është guri mbi të cilin u ngjit Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur ndërtoi Qaben. Ai është një prej shenjave të qarta në Harem, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

فِيهِ آيَاتٌ بَيْنَاتٌ مَّقَامِ إِبْرَاهِيمَ

“Në të ka shenja të qarta (që janë): Vendi i Ibrahimit (Mekami i Ibrahim).”

- **Vendndodhja:** Ndodhet para derës së Qabes, 10-11 m në lindje të saj.
- **Forma:** Ka formë katrore të sheshtë; në mes janë gjurmët e këmbëve të Ibrahimit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) të gdhendura në formë vezake.
- **Ngjyra:** Është mes ngjyrës së bardhë, të zezë dhe të verdhë.
- **Përmasa:** Gjerësia, gjatësia dhe lartësia janë 50 cm.
- Në ditët e sotme, Mekami është vendosur në një kabinë xhami transparente.
- Është mbuluar me argjend nga të gjitha anët.

Për ata që bëjnë tauaf në Shtëpinë e Shenjtë dhe kanë mundësi, preferohet të falin dy rekate, pas Mekamit, edhe nëse qëndrojnë larg tij (Mekamit), siç ka thënë i Plotfuqishmi:

وَاتَّخِذُوا مِنْ مَّقَامِ إِبْرَاهِيمَ مُصَلًّى

“Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!”

Kujdesuni të zbatoni udhëzimet e sigurisë dhe të mos dëmtoni apo ngushtoni të tjerët gjatë namazit. Ju mund të faleni kudo pas Mekamit të Ibrahimit, larg turmave ose kudo në Xhaminë e Shenjtë.

Safaja dhe Meruaja

Janë dy kodra të vogla mbi të cilat u ngjit Haxhireja (nëna e Ismailit - Paqja e Allahut qoftë mbi të!), në kërkim të ushqimit ose ujit.

Safaja: Është një kodër e vogël nga ku fillon saji. Shkëmbinjtë malorë janë ende të dukshëm në katin e poshtëm ku bëhet saji.

Meruaja: Është një kodër vogël ku përfundon saji.

Saji ndërmjet Safasë dhe Meruasë është një nga ritualet e haxhit dhe umres. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ

“Kodrinat Safa dhe Merua (në Mekë) janë pjesë e Simboleve të Allahut.”

Pusi i Zemzemit

- Ndodhet në lindje të Qabes, 21 metra larg saji.
- Perimetri i grykës së pusit është 3.60 m.

Nga emrat e Zemzemit:

Janë këto: sukja (uji që piu) e Ismailit, i kulluari, i bekuari, i sigurti, i pastri.

Kalifët dhe mbretërit gjatë gjithë shekujve janë kujdesur shumë për pusin e Zemzemit. Kjo përkujdesje vazhdoi edhe në epokën Mbretërisë së Arabisë Saudite, duke filluar nga periudha e sundimit të mbretit Abdulaziz (Allahu e mëshiroftë!):

- Në vitin 1345 hixhri mbreti Abdulaziz (Zoti e mëshiroftë!) urdhëroi të hapej një rrugë, me qëllim që të shfrytëzohej uji i pusit Zemzem.
- Pastaj, në vitin pasardhës, ai urdhëroi ndërtimin e një shtegu të dytë; gjithashtu u riparua pusi dhe mbi të u vendos një mbulesë.

Investimet kanë vazhduar deri në kohën e sundimit të mbretit Selman (Allahu e ruajttë!):

- Viti 1439 hixhri përkoi me përfundimin e punimeve në pusin Zemzem.
- Janë krijuar i pesë kanale për shërbimet e Zemzemit.

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë

Zemzem: Ky ent mbikëqyr të gjitha punët që kanë të bëjnë me pusin Zemzem, për t'ua ofruar haxhinjve dhe vizitorëve të Qabes ujin sipas standardeve më të larta të cilësisë.

Laboratori Zemzem:

- Njëpërmjet tij realizohet mbikëqyrja gjatë gjithë fazave të sterilizimit të ujit Zemzem.
- Mbikëqyr mbushjen e rezervuarëve, që e çojnë ujin Zemzem në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Ndër shërbimet e ofruara në Xhaminë e Shenjtë (Qabe)

Shërbimi i përkthimit të të hutbes së xhumasë:

Përkthimi i hutbes së xhumasë mund të dëgjohet në disa gjuhë, përmes platformës “Menaratu el Harameji esh-Sherifejni”. Kjo platformë ofron predikimin e përkthyer audio, njëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja).

Për t’iu përgjigjur pyetjeve të vizitorëve të Qabesë dhe gjithë besimtarëve, në gjithë Xhaminë e Shenjtë ka telefona të dedikuar në shtatë gjuhë ndërkombëtare.

Shërbimi i karrocave: Në Xhaminë e Shenjtë ka një numër të madh karrocash elektrike dhe manuale.

Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara:

- Përkthimi i hutbes së xhumasë është i disponueshëm në gjuhën e shenjave për njerëzit me aftësi të kufizuara në dëgjim. Ky shërbim ofrohet në Xhaminë e Shenjtë te zona e zgjerimit të mbretit Fehd, Porta nr. 64.

- Shpërndarja e CD-ve dhe sixhadeve për faljen në gjuhën e shenjave për personat me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe shikim.
- Ndarja e hapësirave për personat me aftësi të kufizuara në Xhaminë e Shenjtë te zona e zgjerimit të mbretit Fehd, në të akomodohen më shumë se 25 persona, përveç faljes së dy rekateve pas tauafit, faltores Exhjad në katin e parë dhe faltores për njerëzit me nevoja të veçanta, që ndodhet te zona e zgjerimit të mbretit Fehd (Allahu e mëshiroftë!) në katin përdhes përballë Portës nr. 67; si dhe faltoret e grave pranë Portës nr. 88 dhe Portës nr. 74 në katin përdhes.
- Sigurimi i një pajisje elektronike Kurani për të verbërit dhe mus'hafe Braile.
- Në Xhaminë e Shenjtë ka një rrugë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Shkallët lëvizëse: Zakonisht do t'ju duhet të ngjiteni ose të zbrisni nëpërmjet shkallëve lëvizëse në Qabe, në oborret e saj dhe për të marrë shërbimet që ofrohen në të.

Këto janë këshillat më të rëndësishme që duhet t'i keni parasysh:

1. Mos u ulni në shkallë, edhe nëse jeni të lodhur.
2. Qëndroni fort në shkallë dhe mbajeni dorën në rripin lëvizës.

3. Gruaja duhet t'i kushtojë kujdes hixhabit (mbulesës), që të mos ngecë në fund të shkallës.

4. Lëvizni menjëherë pasi shkalla të arrijë në fund, në mënyrë që të mos përplaseni me ata që janë pas jush.

5. Mos i ngjitni karrocet në shkallë, përveçse me ndihmën e një specialisti.

6. Nëse keni një të moshuar ose një person që nuk është mësuar të kalojë shkallët, qendroni pranë tij dhe mbajeni për ta mbrojtur që të mos bjerë.

7. Mos u bëni pjesë e rrëmujës dhe mos dëmtoni haxhinjtë, nëse përballeni me ndonjë turmë në fillim të ngjitjes dhe zbritjes; si dhe lini një mundësi për vëllezërit tuaj.

8. Mos e vendosni këmbën në furçën anësore nën shkallë, sepse kjo mund t'ju lëndojë dhe të prishë shërbimin e pastrimit të shkallëve.

Mali Theur

Mali Theur ndodhet në jug të Xhamisë së Shenjtë (Qabesë). Është 4 km nga Meka e Nderuar. Është afërsisht 748 m i lartë.

Në këtë mal ndodhet shpella e Theurit. Është shpella në të cilën Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) qëndroi me shokun e tij Ebu Bekrin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) për tri netë gjatë shpërnguljes (hixhretit) për në Medinë;

qendroi i fshehur nga sytë e idhujtarëve. Ai ishte nën kujdesin e veçantë të Allahut. Allahu e ruajti dhe e ndihmoi. Allahu i Lartësuar thotë:

فقد نصره الله إذ أخرجه الذين كفروا ثاني اثنين إذ هما في الغار إذ يقول لصاحبه
لا تحزن إن الله معنا

“Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): “Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!”

Shpella e Theurit përbëhet nga një shkëmb i zbrazët, 1.25 m i lartë; dhe dy çarje: njëra në anën lindore dhe tjetra në anën perëndimore. Ajo ndodhet në anën veriore, në majën e malit Theur. Vizita e kësaj shpelle nuk është prej dispozitave të umres dhe të haxhit; nuk është e pëlqyeshme të vizitohet. Shkuarja në shpellën e Theurit është e vështirë për të moshuarit dhe të sëmurët, për shkak të distancës së gjatë dhe vështirësisë së rrugës që të çon tek ajo.

Mali Nur (mali i Dritës) dhe shpella Hira

- Është vendi ku Allahu e nderoi Profetin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) me pozitën lartë e sublime të Profecisë.
- Në këtë shpellë ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e adhuronte Allahun dhe meditonte rreth krijesave të Tij.

• Historia e njerëzimit ndryshoi pikërisht në këtë shpellë, kur Xhibrili i zbriti Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) Shpalljen prej Allahut të Lartësuar.

• Pesë ajetet e para të sures el Alak shënuan fillimin e Shpalljes:

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ، خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ، اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ، الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ، عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, e mësoi njeriun të shkruajë me penë, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”

• Vendodhja: Shpella Hira ndodhet në veri të Xhamisë së Shenjtë, në majë të malit Nur.

• Mes saj dhe Mekës është një distancë rreth 4.8 km.

• Lartësia mbi tokë është afërsisht 634 m.

Kjo shpellë është një zgavër me derë (hyrje) në drejtim të veriut.

• Në këtë shpellë mund të strehohen deri në 9 persona të ulur.

• Ajo ka lartësinë e një njeriu me shtat mesatar.

Vizita e kësaj shpelle nuk është prej dispozitave umres dhe të haxhit; nuk është e pëlqyeshme të vizitohet. Është e vështirë për të moshuarit dhe të sëmurët të arrijnë atje.

Xhamia e Nënës së Besimtarëve, Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) – Mikati i Teneimit

Është një xhami historike e ngritur në vendin nga ku Nëna e Besimtarëve Aishja, e bija Ebu Bekër Sidikut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), bëri nijetin për umre pas Haxhit të Lamtumirës.

- Ndodhet në pjesën perëndimore të Mekës.
- Është 7 km larg nga Xhamia e Shenjtë e Mekës.
- Është një nga kufijtë e Haremit, nga veriperëndimi.
- Banorët e Mekës e bëjnë nijetin për haxh dhe umre nga mikati i Teneimit, sepse ky mikat është pika më e afërt jashtë Haremit për ta.
- Për herë të parë kjo xhami është ndërtuar në kohën e kalifit el Muteuekil në vitin 240 hixhri.
- Është rindërtuar gjatë sundimit të mbretit Fehd (Allahu e mëshiroftë!).
- Personi që dëshiron të përsërisë umren, pas marrjes së lejes përmes një aplikacioni, e bën nijetin nga mikati i Teneimit.

Xhamia el Bejatu (Xhemeratet)

Është një xhami e vogël historike e ndërtuar në vendin ku ensarët (banorët e Medinës) takuan Profetin (Paqja e

Allahut qoftë mbi të!) gjatë haxhit dhe i dhanë besën atij se do ta ndihmonin e do ta mbronin, kur ai shpërngulej dhe migronte tek ata.

I pari që e ndërtoi këtë xhami është kalifi abasit Ebu Xhafer el Mensuri, në vitin 144 hixhri.

Vendndodhja e saj: Ndodhet rreth 500 metra larg nga Xhemerati i Madh (i Akabesë).

Kjo xhami është një faltore e vogël pa çati; ka mihrab dhe oborr. Edhe sot e kësaj ditë, xhamia ruan disa nga mbishkrimet e saj arkeologjike.

Xhamia Aishe er-Raxh'hi

- Është një xhami model për ndërtimin e xhamive me infrastrukture të përsosur.
- Është një nga xhamitë më të mëdha në rajonin e Mekës.
- Dallohet për shërbimet e shumta dhe aktivitetet e larmishme.

Vendndodhja: Lagjja en-Nesim në Mekën e Nderuar.

Viti i përrurimit: 1434 hixhri.

Sipërfaqja e xhamisë: 60 864 m².

Hapësira e jashtme: 10 000 m².

Numri i besimtarëve që mund të falen njëkohësisht në të është 47000.

Numri i kateve: 6 kate.

Disa nga shërbimet e veçanta të xhamisë:

- Ofrimi i programeve sociale.
- Ofrimi i programeve arsimore.
- Ofrimi i shërbimeve vullnetare gjatë sezoneve të adhurimit (si p.sh. në kohën e haxhit).
- Pritja e delegacioneve nga brenda dhe jashtë.

Ekspozita e Mbulesës së Qabes

Në këtë ekspozitë pasqyrohen fazat dhe mekanizmat e thurjes së Mbulesës së Qabes, si dhe historia e saj, duke përfshirë kaligrafinë e ajeteve kuranore dhe mbishkrimet.

Çfarë mund të shohë vizitori?

- Vizitori mund të shohë nga afër ajetet kuranore të shkruara në Mbulesën e Qabes.
- Të shohë detajet e Mbulesës së Qabes në të katër anët (këndet) e saj.
- Të njihet me historinë e Mbulesës së Qabes dhe të disa prej pjesëve të saj të vjetra.

- Të mësojë rreth përpjekjeve të Mbretërisë së Arabisë Saudite në shërbim të Qabes dhe për mbulimin e saj.
- Të njihet me fazat nëpër të cilat ka kaluar industria së mbulimit të Qabes në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe fazat e transformimit të saj.

Nganjëherë, vizitorët mund të marrin pjesë në qëndisjen e Mbulesës së Qabes.

Vendodhja e saj: Fabrika e Mbulesës së Qabes dhe Ekspozita e saj janë të vendosura në Mekë në rrugën e Xhedës.

Muzeu i Kullës së Sahatit

Është një muze astronomik i vendosur në ballkonin e Kullës së Sahatit, në pikën më të lartë të Mekës. U përrua në Ramazan të vitit 1440 hixhri.

Funksionet e muzeut, sipas kateve:

- Kati i parë: Prezantohet çfarë ka të bëjë me Kullën e Sahatit të Mekës (ndërtimi, veçoritë, teknologjia etj.).
- Kati i dytë: Të tregojë për mënyrat e matjes së kohës, risitë njerëzore dhe përpjekjet për të njohur kohën.
- Kati i tretë: Ju njeh me Diellin, Tokën, Hënë dhe me gjithçka që lidhet me to.

• Kati i katërt: Shërben për të shfaqur universin në përgjithësi (yjet, konstelacionet -yjësitë, planetët, fenomenet astronomike).

Ekspozita nxjerr në pah rolin e studiuesve muslimanë në shkencat hapësinore.



KAPITULLI VI

LUTJE

NGA KURANI DHE SUNETI

Në këtë udhëzues, do të mësoni lutje të zgjedhura nga Kurani i madhërishëm dhe Suneti i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), për t'u lutur me to gjatë kryerjes së riteve.

Lutja

- Lutja është thelbi i adhurimit, sepse nëpërmjet saj robi, pranon dobësinë dhe varfërinë e tij, i drejtohet Krijuesit të Lartësuar më përgjërëm e përrulësi, i kërkon Atij prej të mirave e begative të kësaj bote dhe të botës tjetër. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"Lutja është adhurim"*.
- Lutja dhe përmendja e Allahut, kthimi tek Ai me pendim dhe shfaqja e varfërisë para Tij, të gjitha këto, janë nga qëllimet më të rëndësishme të umres dhe haxhit. Lutja është pjesë e qenësishme e umres dhe e haxhit në të gjitha gjendjet, rrethanat dhe fazat e tyre. Prandaj, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *"Tauafi rreth Shtëpisë së Shenjtë, saji ndërmjet Safasë e Meruasë dhe gjuajtja e guralecëve në Xhemerate, të gjitha këto rituale të haxhit, janë caktuar për t'u përmendur Allahu i Lartësuar."*

Në këtë udhëzues do të gjeni informacione të dobishme dhe detaje të ndryshme rreth lutjeve, si dhe lutje të zgjedhura kuranore e profetike, për t'ju shoqëruar gjatë gjithë kohës në udhëtimin tuaj të umres apo haxhit.

Rregullat e lutjes

- Allahu i Lartësuar është afër robërve të Tij; i dëgjon lutjet dhe i përgjigjet kërkesave të tyre. Lutja e cila mishëron në vetvete etikën që na ka mësuar Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe kryet sipas rregullave të përpikta, është më afër përgjigjes (pranimit). Allahu i Lartësuar thotë:

وإذا سألك عبادي عني فإني قريب أجيب دعوة الداع إذا دعان فليستجيبوا لي
وليؤمنوا بي لعلمهم يرشدون

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”

Disa nga rregullat e lutjes:

- T’i lutesh Allahut me emrat e Tij të bukur. Allahu i Lartësuar ka thënë:

ولله الأسماء الحسنى فادعوه بها وذروا الذين يلحدون في أسمائه

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, prandaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij.”

Kështu p.sh.: nëse i kërkon Allahut të Lartësuar mëshirë, thuaj: *“O i Gjithëmëshirshëm, më mëshiro!”* Nëse i kërkon Allahut të Lartësuar falje, thuaj: *“O Falës, më fal!”*

- Ta fillosh lutjen me lavdërimin e Allahut të Lartësuar dhe dërgimin e salavateve mbi të Dërguarin e Tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

- Kur lutesh, i ngre duart dhe i kërkon Allahut si një nevojtar i përrulur. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *“Vërtet që Allahu i Lartësuar është i Turpshëm e Bujar. Ai turpërohet t’ia kthejë duart bosh robit të Vet, kur i ngre ato drejt Tij.”*

- Prania e zemrës dhe siguria se Allahu e dëgjon lutjen e tënde dhe i përgjigjet asaj. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *“Lutjuni Allahut duke qenë të sigurt se Ai do t’ju përgjigjet. Dhe dijeni se Allahu nuk i përgjigjet lutjes nga një zemër e shkujdesur dhe e hutuar.”*

- Të lutesh në mënyrë të përsëritur dhe me këmbëngulje; të mos nxitohesh në pritjen e përgjigjes, siç thotë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *“Allahu i përgjigjet lutjes së robit, kur ajo nuk përmban në vetvete mëkat dhe as tendencë për shkëputjen e lidhjeve të gjakut, si dhe kur ai nuk tregohet i nxituar’.* I thanë: ‘O i Dërguar i Allahut, çfarë ke për qëllim me fjalën ‘nxitim’?’ Ai tha: *‘Robi nxitohet, kur thotë: ‘U luta, u luta, por nuk m’u plotësua lutja!’ Për këtë arsye, ai brengoset dhe e braktis lutjen.”*

- Të lutesh me përrulësi e frikërespekt, duke ndjerë dobësinë tënde dhe se ti ke shumë nevojë për Allahun, si dhe duke qenë i bindur që Zoti yt i Lartësuar është i Pasur, i Vetëmjaftueshëm dhe i Gjithëfuqishëm. Ti shpreson në shpërblimit e Tij dhe ke frikë nga dënimi i Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

إنهم كانوا يسارعون في الخيرات ويدعوننا رغباً ورهباً وكانوا لنا خاشعين

“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlur ndaj Nesh.”

- Lutja të jetë e fshehtë, me zë pëshpëritës e të padëgjueshëm për të tjerët. Allahu i Lartësuar thotë:

ادعوا ربكم تضرعاً وخفية

“Lutjuni Zotit tuaj me përlësi dhe në fshehtësi!”

Lutje nga Kurani i madhërishëm

● رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ، وَتُبْ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

► Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! O Zoti ynë! Pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”

● رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ
● رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ
● رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

► Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!

► Zoti ynë! Na i fal gjynahet dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”

► Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi nga të humburit.

◆

• رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

• رَبَّنَا إِنَّا أَمَّا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

• رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً إِنَّكَ سَمِيعُ الدُّعَاءِ

► Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!

► Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit!

► Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!

◆

• رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

• رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ وَاعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

- ▶ Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!
- ▶ Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!



- رَبِّ هَبْ لِي حُكْمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ وَاجْعَلْ لِي لِسَانَ صِدْقٍ فِي الْآخِرِينَ وَاجْعَلْنِي مِنْ وَرَثَةِ جَنَّةِ النَّعِيمِ
- وَلَا تُخْزِنِي يَوْمَ يُبْعَثُونَ يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ
- رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَى وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ

- ▶ Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme dhe më bëj një nga trashëgimtarët e Xhenetit të begatë!
- ▶ Dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t'i

bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!

► Zoti im, më frymëzo të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe ma mundëso të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!



- رَبِّ اجْعَلْ هَذَا الْبَلَدَ آمِنًا وَاجْنُبْنِي وَبَنِيَّ أَنْ نَعْبُدَ الْأَصْنَامَ
- رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي رَبَّنَا وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ
- رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ
- رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا
- لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

► Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!

► Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!

► Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!

► Zoti im, shtoma diturinë!

► S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!

- ◆
- رَبِّ لَا تَذَرْنِي فَرْدًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ
 - رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ
 - رَبَّنَا آمَنَّا فَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّاحِمِينَ
 - رَبِّ اغْفِرْ وَارْحَمْ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّاحِمِينَ
 - رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

- ▶ Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë.
- ▶ Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e djajve, dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos i kem pranë meje.
- ▶ Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!
- ▶ Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!
- ▶ Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!

- ◆
- اللَّهُمَّ أَنْتَ وَلِيُّنَا فَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الْغَافِرِينَ وَانْتَبْ
 - لَنَا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ
 - حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

• اللَّهُمَّ يَا فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَنْتَ وَلِيِّي فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ
تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ

► (O Zoti ynë!) Ti je Mbrojtësi ynë, andaj falna dhe mëshirona! Ti je më i miri i mëshiruesve! Na cakto të mira në këtë botë dhe në tjetrën.

► Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!

► (O Zoti im!) O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Ma mundëso të vdes si musliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!



• رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا وَاعْفِرْ لَنَا رَبَّنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ
الْحَكِيمُ

• رَبَّنَا أْتَمِّمْ لَنَا نُورَنَا وَاعْفِرْ لَنَا إِنَّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

• رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي مُؤْمِنًا وَلِلْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُؤْمِنَاتِ

► Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobesimtarët dhe falna ne, o Zot. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.

► Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.

- ▶ Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtaret!



- رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي
- رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَى وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ
- رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَؤُوفٌ رَحِيمٌ
- رَبَّنَا عَلَيْكَ تَوَكَّلْنَا وَإِلَيْكَ أَنبَأْنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ

- ▶ Zoti im! Njëmend, Unë i kam bërë keq vetes, andaj më fal!
- ▶ Zoti im! Më frymëzo të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ti kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!
- ▶ Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!
- ▶ Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohem dhe tek Ti do të kthehem.

Lutje Profetike

- اللَّهُمَّ اهْدِنِي لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ، إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ تَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ.
- اللَّهُمَّ ثَبِّتِي بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ.

- ▶ Zoti ynë, me lejën e vullnetin Tënd, na udhëzo drejt së vërtetës në çështjet për të cilat ka mospajttime midis robërve të Tu. Sigurisht që Ti udhëzon në rrugën e drejtë atë që do!
- ▶ Zoti ynë, na forco me fjalë të qëndrueshme në jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër!

- اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةٌ أَمْرِي، وَأَصْلِحْ لِي دُنْيَايَ الَّتِي فِيهَا مَعَاشِي، وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَعَادِي، وَاجْعَلْ الْحَيَاةَ زِيَادَةً لِي فِي كُلِّ خَيْرٍ، وَاجْعَلْ الْمَوْتَ رَاحَةً لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى، وَالتَّقَى، وَالْعَفَافَ، وَالْغِنَى

► Zot, përmirësoje fenë time, e cila është mbrojtja e çështjes sime; përmirësoje botën time, në të cilën kam jetesën time; përmirëso për mua botën tjetër (pas ringjalljes), te e cila do të kthehem; ma zgjat jetën për punë të mira dhe ma bëj vdekjen shpëtim nga çdo e keqe!

► Zoti ynë! Ne kërkojmë prej Teje udhëzime, devotshmëri, nder dhe pasuri!



• اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ النَّارِ وَعَذَابِ النَّارِ، وَفِتْنَةِ الْقَبْرِ، وَعَذَابِ الْقَبْرِ، وَشَرِّ فِتْنَةِ الْغِنَى، وَشَرِّ فِتْنَةِ الْفَقْرِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْ قَلْبِي بِمَاءِ الثَّلْجِ وَالْبَرْدِ، وَنَقِّ قَلْبِي مِنَ الْخَطَايَا كَمَا نَقَيْتَ الثُّوبَ الْأَبْيَضَ مِنَ الدَّنَسِ، وَبَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ. اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَالْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ

► O Zot ynë! Na ruaj nga sprova dhe dënimi i Zjarrit, nga sprova dhe dënimi i varrit, nga shërrit i sprovës së pasurisë dhe nga shërrit i sprovës së varfërisë! O Zoti ynë, na ruaj nga shërrit i sprovës së Dëshalut! O Zoti ynë, na pastro nga gabimet me ujë, borë e akull; na pastro nga gjynahet ashtu sikurse pastrohen rrobat e bardha nga njollat! Na largo nga

*gjynahet, sa largësia e lindjes me perëndimin! O
Zotí ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga
përtacia, mëkatí dhe borxhi!*



- *اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ، وَالْكَسَلِ، وَالْجُبْنِ، وَالْهَرَمِ،
وَالْبُخْلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا
وَالْمَمَاتِ.*
- *اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ جَهْدِ الْبَلَاءِ، وَدَرَكِ الشَّقَاءِ، وَسُوءِ
الْقَضَاءِ، وَشَمَاتَةِ الْأَعْدَاءِ*

► *Zotí ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga pafuqia
e dembelizmi, nga frika dhe koprracia; kërkojmë
mbrojtjen Tënde prej moshës së thyer e mjerane
(në të cilën humbet vetëdija)! O Zotí ynë,
kërkojmë mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit
dhe nga sprovat e jetës dhe të vdekjes!*

► *Zot ynë, kërkojmë mbrojtjen Tënde nga
belatë e mëdha e të papërballueshme, nga rënia
në dëshpërim, nga fatkeqësitë dhe nga
ngazëllimi i armiqve!*



- اللَّهُمَّ حَبِّبْ إِلَيْنَا الْإِيمَانَ وَزَيِّنْهُ فِي قُلُوبِنَا، وَكْرِهْ إِلَيْنَا الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ، وَاجْعَلْنَا مِنَ الرَّاشِدِينَ
- اللَّهُمَّ قِنِي شَحَّ نَفْسِي وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُفْلِحِينَ.
- اللهم آتنا في الدنيا حسنة، وفي الآخرة حسنة وقتنا عذاب النار

► *Zoti ynë! Na e bëj të dashur besimin dhe zbukuroje atë në zemrat tona; na e bëj të urryer mosbesimin, shthurjen e mosbindjen dhe na bëj prej të drejtëve!*

► *Allah, më ruaj nga koprracia dhe më bëj prej të suksesshmëve!*

► *Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!*



- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ، وَالْكَسَلِ، وَالْجُبْنِ، وَالْبُخْلِ، وَالْهَرَمِ، وَعَذَابِ الْقَبْرِ
- اللَّهُمَّ أَتِ نَفْسِي تَقْوَاهَا، وَزَكَّهَا أَنْتَ خَيْرٌ مَن زَكَّاهَا، أَنْتَ وَلِيُّهَا وَمَوْلَاهَا
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ، وَمِنْ قَلْبٍ لَا يَخْشَعُ، وَمِنْ نَفْسٍ لَا تَشْبَعُ، وَمِنْ دَعْوَةٍ لَا يُسْتَجَابُ لَهَا

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga paaftësia dhe përtacia, nga frika, koprracia dhe pleqëria; na ruaj nga dënimi i varrit!*

► *Zot, jepi shpërtrave tanë devotshmërinë; pastroji ata; Ti je më i miri që i pastron; Ti je Mbrojtësi dhe Kujdestari i tyre.*

► *Zot! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga ajo dituri që nuk ka dobi, nga ajo zemër që nuk të frikësohet Ty, nga ai shpirt që nuk ka ngopje dhe nga ajo lutje që Ti nuk e pranon!*



• **اللَّهُمَّ إِنِّي عَبْدُكَ ابْنُ ابْنِ أُمَّتِكَ، نَاصِيَتِي بِيَدِكَ، مَاضٍ فِيَّ حُكْمُكَ، عَدْلٌ فِيَّ قَضَاؤُكَ، أَسْأَلُكَ بِكُلِّ اسْمٍ هُوَ لَكَ سَمَّيْتَ بِهِ نَفْسَكَ، أَوْ أَنْزَلْتَهُ فِي كِتَابِكَ، أَوْ عَلَّمْتَهُ أَحَدًا مِنْ خَلْقِكَ، أَوْ اسْتَأْثَرْتَ بِهِ فِي عِلْمِ الْغَيْبِ عِنْدَكَ، أَنْ تَجْعَلَ الْقُرْآنَ رَبِيعَ قَلْبِي، وَنُورَ صَدْرِي، وَجَلَاءَ حُزْنِي، وَذَهَابَ هَمِّي.**

► *Zot! Ne jemi robërit e Tu, bijtë e robërve e robëreshave të Tua! Balli ynë (qenia jonë) është në dorën Tënde! Gjykimin Tënd mbi ne e pranojmë! Gjykimin Yt mbi ne është i drejtë! Të lutemi me çdo emër që e ke cilësuar Vetën Tënde, ose që e ke shpallur në Librin Tënd (në*

Kuran), apo ia ke mësuar ndonjërit prej krijesave të Tua apo e ke ruajtur në dijen Tënde të fshehtë; të lutemi, o Zoti ynë, ta bësh Kuranin pranverë të zemrave tona dhe dritë të gjokseve tona, shkarkim të pikëllimeve tona dhe largim të dëshpërimeve tona!



- اللَّهُمَّ أَكْثَرَ مَالِي، وَوَلَدِي، وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَنِي، وَأَطِلْ حَيَاتِي عَلَى طَاعَتِكَ، وَأَحْسِنْ عَمَلِي، وَاعْفِرْ لِي.
- لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْعَظِيمُ الْحَلِيمُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ السَّمَوَاتِ، وَرَبُّ الْأَرْضِ، وَرَبُّ الْعَرْشِ الْكَرِيمِ.

► Zot! Na i shto pasurinë (materiale dhe shpirtërore); na jep pasardhës besimtarë; na jep bereqet në gjithçka që na ke dhuruar! Na jep jetë të gjatë në bindjen ndaj Teje dhe na e mundëso ti përmirësojmë punët tona dhe na fal!

► Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, të Madhërishmit, Duruesit! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, Zotit të Arshit madhështor! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, Zotit të shtatë qiejve, Zotit të Tokës, Zotit të Arshit të nderuar!

◆

• اللَّهُمَّ رَحْمَتَكَ أَرْجُو فَلَا تَكْنِي إِلَى نَفْسِي طَرْفَةَ عَيْنٍ، وَأَصْلِحْ
 لِي شَأْنِي كُلَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ.
 • لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

► *Zoti ynë! Mëshirën Tënde shpresojmë, mos na lër të mbështetemë në veten tonë asnjë çast të shkurtër, sa hapen e mbyllën sytë! Rregullona çdo aspekt të jetës sonë, përmirësoje gjendjen tonë, nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Teje!*

► *S'ka zot tjetër që meriton të adhurohet, përveç Teje (o Allah)! Qofsh i lavdëruar dhe pa të meta! Me të vërtetë, unë kam gabuar!*

◆

• اللَّهُمَّ اهْدِنِي وَسَدِّدْنِي، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى وَالسَّدَادَ.
 • اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ زَوَالِ نِعْمَتِكَ، وَتَحَوُّلِ عَافِيَتِكَ، وَفُجَاءَةِ
 نِقْمَتِكَ، وَجَمِيعِ سَخَطِكَ.
 • اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا عَمِلْتُ، وَمِنْ شَرِّ مَا لَمْ أَعْمَلْ

► *Zoti im, më udhëzo dhe më drejto në rrugën e drejtë. O Zot, të kërkoj udhëzim dhe drejtësi (në fjalë e në vepra)!*

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde mos i humbasim mirësitë e begatitë e Tua dhe shëndetin që na ke dhuruar. Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga ndëshkimi Yt i papritur dhe nga gjithë zemërimi Yt!*

► *Zoti im, kërkoj mbrojtje te Ti nga e keqja e asaj që kam bërë dhe nga e keqja e asaj që nuk e kam bërë!*



• اللَّهُمَّ مُصَرِّفَ الْقُلُوبِ صَرِّفْ قُلُوبَنَا عَلَى طَاعَتِكَ.

• يَا مُقَلِّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ.

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ [الْيَقِينِ] و [الْعَفْوِ] وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ.

• اللَّهُمَّ أَحْسِنْ عَاقِبَتَنَا فِي الْأُمُورِ كُلِّهَا، وَأَجِرْنَا مِنْ خِزْيِ الدُّنْيَا وَعَذَابِ الْآخِرَةِ

► *Zot! O Ti që i drejton zemrat, drejto zemrat tona në bindjen ndaj Teje!*

► *Zot! O Ti që i ndryshon zemrat, forco zemrat tona në fenë Tënde!*

► *Zoti ynë! Kërkojmë prej Teje bindje të patundur, falje dhe mbarësi në këtë botë e në botën tjetër!*

► *Zoti ynë! Na jep përfundim të mirë (të lumtur) në të gjitha çështjet dhe na shpëto nga poshtërimi i kësaj bote dhe dënimi i botës tjetër!*



- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ: عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ.
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ [مَا اسْتَعَاذَ بِكَ] [مِنْهُ] عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ. وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ.
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ، وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَسْأَلُكَ أَنْ تَجْعَلَ كُلَّ قَضَاءٍ قَضَيْتَهُ لِي خَيْرًا

► *Zoti ynë! Ne kërkojmë nga të gjitha mirësitë, të kësaj bote dhe të botës tjetër, ato që i njohim dhe ato që nuk i njohim! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga të gjitha ligësitë, të kësaj bote dhe të botës tjetër, ato që i njohim dhe ato që nuk i njohim!*

► *Zoti! Ne të kërkojmë gjithë ato mirësi që i ka kërkuar rob i Dërguari yt, Muhamedi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); dhe kërkojmë mbrojtje prej gjithë të këqijave, sikurse ka*

kërkuar mbrojtje i Dërguari Yt, Muhamedi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); S'ka fuqi dhe ndryshim pa vullnetin dhe ndihmën Tënde!

► Zoti ynë! Ne të kërkojmë Xhenetin dhe çdo fjalë e vepër që na afron drejt tij! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga Zjarri dhe nga çdo fjalë e vepër që të afron drejt tij! Të lutemi që çdo caktim i Yti për ne të jetë i mirë!



- اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ، وَنَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ، وَأَنْتَ الْمُسْتَعَانُ ، وَعَلَيْكَ الْبَلَاغُ ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ .
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبَرَصِ ، وَالْجُنُونِ ، وَالْجُدَامِ ، وَمِنْ سَيِّئِ الْأَسْقَامِ

► Zoti ynë! Ne të kërkojmë gjithë ato mirësi që të ka kërkuar i Dërguari Yt, Muhamedi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); dhe kërkojmë mbrojtje prej gjithë të këqijave, sikurse ka kërkuar mbrojtje i Dërguari Yt, Muhamedi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); Vetëm prej Teje kërkohet ndihma dhe vetëm prej Teje ajo vjen me siguri! S'ka fuqi dhe ndryshim pa vullnetin dhe ndihmën Tënde!

► Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga lebra, çmenduria dhe nga çdo sëmundje e keqe!

● اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ مُنْكَرَاتِ الْأَخْلَاقِ، وَالْأَعْمَالِ، وَالْأَهْوَاءِ.
● اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوفٌ كَرِيمٌ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي

► Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga sjelljet e këqija, nga punët e këqija dhe nga dëshirat e keqija!

► Zoti ynë! S'ka dyshim se Ti je Falës i Madh e Bujar! Ti e do faljen; të lutemi na fal!

● اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ، وَتَرْكَ الْمُنْكَرَاتِ، وَحُبَّ الْمَسَاكِينِ، وَأَنْ تَغْفِرَ لِي، وَتَرْحَمَنِي، وَإِذَا أَرَدْتَ فِتْنَةَ قَوْمٍ فَتَوَفَّنِي غَيْرَ مَفْتُونٍ، وَأَسْأَلُكَ حُبَّكَ، وَحُبَّ مَنْ يُحِبُّكَ، وَحُبَّ عَمَلٍ يُقَرِّبُنِي إِلَى حُبِّكَ.

► Zoti ynë! Ne kërkojmë lehtësimin e veprave të mira, braktisjen e veprave të ndyra dhe dashuri për te varfrit! Na fal e na mëshiro! O Zot, nëse dëshiron të sprovosh ndonjë popull, bëj që të mos jemi me ta. O Zot, kërkojmë dashurinë

Tënde, dashuri për ata që të duan Ty dhe dashuri për veprat që na afrojnë te dashuria Jote!



• رَبِّ اعْنِي وَلَا تُعِنِّ عَلَيَّ، وَأَنْصُرْنِي وَلَا تَنْصُرْ عَلَيَّ، وَامْكُرْ لِي وَلَا تَمْكُرْ عَلَيَّ، وَاهْدِنِي وَيَسِّرِ الْهَدَى إِلَيَّ، وَأَنْصُرْنِي عَلَى مَنْ بَغَى عَلَيَّ

• رَبِّ اجْعَلْنِي لَكَ شَاكِرًا، لَكَ ذَكَرًا، لَكَ رَهَابًا، لَكَ مَطْوَعًا، إِلَيْكَ مُخْبِتًا أَوْ آهًا مُنِيبًا، رَبِّ تَقَبَّلْ تَوْبَتِي، وَاغْسِلْ حَوْبَتِي، وَأَجِبْ دَعْوَتِي، وَثَبِّتْ حُجَّتِي، وَاهْدِ قَلْبِي، وَسَدِّدْ لِسَانِي، وَاسْأَلْ سَخِيمَةَ قَلْبِي

► Zot, na ndihmo dhe mos i ndihmo të tjerët kundër nesh; na mbështet dhe mos i mbështet të tjerët kundër nesh; kurdís plane pro nesh dhe jo kundër nesh; na udhëzo në rrugën e drejtë dhe na e bëj të lehtë orientimin; na ndihmo kundër atyre që na dëmtojnë!

► Zotí ynë, na bëj Të të falënderojmë e Të të përmendim shumë! Na bëj të bindur, të përuhur, të përgjëruar e të përkushtuar ndaj Teje! O Zotí ynë, na e prano pendimin; na i fal gjynahet; përgjigju lutjeve tona; vërteto provat tona; na i udhëzo zemrat; na ndihmo që të themí

gjithmonë të vërtetën dhe largo urrejtjen nga zemrat tona!



• **اللَّهُمَّ احْفَظْنِي بِالْإِسْلَامِ قَائِماً، واحْفَظْنِي بِالْإِسْلَامِ قَاعِداً،
واحْفَظْنِي بِالْإِسْلَامِ رَاقِداً، ولا تُشْمِتْ بِي عَدُوّاً ولا حاسِداً.
اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ كُلِّ خَيْرٍ خَزَائِنُهُ بِيَدِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ
كُلِّ شَرٍّ خَزَائِنُهُ بِيَدِكَ**

► *Zoti ynë! Na ruaj nëpërmjet Islamit në të gjitha gjendjet: në këmbë, ulur e shtrirë! O Zot, mos ua mundëso ziliqarëve dhe armiqve tanë të ngazëlleshen me gjendjen tonë (jo të mirë)! O Zot, çdo e mirë është në dorën Tënde; ne kërkojmë prej mirësive të Tua të pashtershme dhe mbrojtjen Tënde nga çdo e keqe!*



• **اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ، وَالْكَسَلِ، وَالْجُبْنِ، وَالْبُخْلِ،
وَالْهَرَمِ، وَالْقَسْوَةِ، وَالْغَفْلَةِ، وَالْعَيْلَةِ، وَالذَّلَّةِ، وَالْمَسْكَنَةِ،
وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْفَقْرِ، وَالْكَفْرِ، وَالْفُسُوقِ، وَالشَّقَاقِ،
وَالنَّفَاقِ، وَالسُّمْعَةِ، وَالرِّيَاءِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الصَّمَمِ،
وَالْبَكَمِ، وَالْجُنُونِ، وَالْجُدَامِ، وَالْبَرَصِ، وَسَيِّئِ الْأَسْقَامِ.**

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga paaftësia dhe përtacia, nga frika dhe koprracia, nga pleqëria dhe zemërngurtësia, nga shkujdesja dhe varfëria, nga poshtërimi dhe vobektësia! O Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga fukarallëku, mosbesimi, shtthurja, përçarja, dyfytirësia, fama e rreme dhe shtirja! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga çmenduria dhe lebra; mos na bëj shurmecë; na ruaj nga çdo sëmundje e keqe!*



- *اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبُخْلِ،
وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ أَنْ أُرَدَّ إِلَى أُرْدَالِ الْعُمَرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ
فِتْنَةِ الدُّنْيَا وَعَذَابِ الْقَبْرِ.*
- *اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي خَطِيئَتِي، وَجَهْلِي، وَإِسْرَافِي فِي أَمْرِي،
وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي هَزْلِي، وَجِدِّي،
وَخَطِيئِي، وَعَمْدِي، وَكُلُّ ذَلِكَ عِنْدِي*

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga frika dhe koprracia; Kërkojmë mbrojtjen Tënde prej moshës së thyer e mjerane (në të cilën humbet vetëdija)! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga sprovat e dynjasë dhe dënimi i varrit!*

► Zot! Na i fal gabimet dhe gjynalet që i bëjmë pa vetëdije dhe tejkalimet e kufijve! Na i fal ato gjynalet të cilat Ti i di më mirë se ne (ne i kemi harruar)! O Zot, fal gjynalet që i kemi bërë me shaka dhe ato të bëra me seriozitet, padashur dhe qëllimisht. O Zot, na fal të gjitha gabimet!



• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ وَرَحْمَتِكَ؛ فَإِنَّهُ لَا يَمْلِكُهَا إِلَّا أَنْتَ
 • اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَرَمِ، وَالتَّرَدِّي، وَالْهَدْمِ، وَالْعَمِّ،
 وَالْغَرَقِ، وَالْحَرَقِ، وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ يَتَخَبَّطَنِي الشَّيْطَانُ عِنْدَ
 الْمَوْتِ، وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ أَمُوتَ فِي سَبِيلِكَ مُذْبِرًا، وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ
 أَمُوتَ لَدِيغًا.

► Zot im, kërkoj prej mirësisë dhe mëshirës Tënde, sepse ato nuk i zotëron askush tjetër përveç Teje.

► Zot ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde prej moshës së thyer e mjerane, nga shkatërrimi dhe rrënim, nga pikëllimi, mbytja dhe djegia! O Zot, kërkojmë mbrojtjen Tënde të mos na mposhtë shejtani në agoninë e vdekjes! O Zot, mos na bëj prej atyre që vriten në rrugën Tënde si dezertorë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde të mos vdesim nga pickimi (i gjarpërinjve)!

● اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ، وَعَزَائِمَ مَغْفِرَتِكَ، وَالسَّلَامَةَ مِنْ كُلِّ إِثْمٍ، وَالْغَنِيمَةَ مِنْ كُلِّ بَرٍّ، وَالْفَوْزَ بِالْجَنَّةِ، وَالنَّجَاةَ مِنَ النَّارِ.

● اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ
● اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، وَوَسِّعْ لِي فِي دَارِي، وَبَارِكْ لِي فِيمَا رَزَقْتَنِي.

► *Zot! Të lutemi na dhuro mëshirën dhe faljen Tënde! Kërkojmë prej Teje shpëtim nga çdo gjynah dhe përfitim nga çdo punë e mirë! O Zot, na mundëso fitimin e Xhenetit dhe shpëtimin nga zjarri i Xhehenemit!*

► *Zot, falë besimtarët dhe besimtaret!*

► *Zot ynë! Falë gjynahet tona; kërkojmë hapësirë të mjaftueshme në shtëpitë tona dhe bekim në rizkun (furnizimin) tonë!*

● اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ. فَاعْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ، وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ
● اللَّهُمَّ لَكَ أَسَلْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَإِلَيْكَ أُنَبْتُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ. اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِعِزَّتِكَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ أَنْ تُضِلَّنِي، أَنْتَ الْحَيُّ الَّذِي لَا يَمُوتُ، وَالْجِنُّ وَالْإِنْسُ يَمُوتُونَ.

► *Zotí ynë! Ne í kemi bërë shumë padrejtësi vetes sonë! Askush tjetër, përveç Teje, nuk í fal gjynahet; prandaj të lutemi na fal e na mëshiro, sepse Tí je Falësi í Madh dhe Mëshirëplotí!*

► *Zotí ynë! Ty të dorëzohemi, Ty të besojmë, vetëm tek Tí mbështetemi, tek Tí drejtohemi dhe për Ty armiqësohemi! Duke dëshmuar se askush nuk meriton të adhurohet, përveç Teje, í lutemi Madhërisë Tënde të mos na shpiesh në rrugë të gabuar! Tí je í Gjallí që nuk vdes, ndërsa xhindët dhe njerëzit vdesin!*



• *اللَّهُمَّ اقسِمْنَا لَنَا مِنْ خَشْيَتِكَ مَا تَحُولُ بِهِ بَيْنَنَا وَبَيْنَ مَعَاصِيكَ،
وَمِنْ طَاعَتِكَ مَا تَبْلُغُنَا بِهِ جَنَّتِكَ، وَمِنْ اليَقِينِ مَا تُهَوِّنُ بِهِ عَلَيْنَا
مَصَائِبَ الدُّنْيَا، اللَّهُمَّ مَتَّعْنَا بِأَسْمَاعِنَا، وَأَبْصَارِنَا، وَقَوَائِمَنَا مَا
أَحْيَيْتَنَا، وَاجْعَلْهُ الْوَارِثَ مِنَّا، وَاجْعَلْ ثَارَنَا عَلَى مَنْ ظَلَمْنَا،
وَأَنْصُرْنَا عَلَى مَنْ عَادَانَا، وَلَا تَجْعَلْ مُصِيبَتَنَا فِي دِينِنَا، وَلَا
تَجْعَلِ الدُّنْيَا أَكْبَرَ هَمِّنَا، وَلَا مَبْلَغَ عِلْمِنَا، وَلَا تُسَلِّطْ عَلَيْنَا مَنْ لَا
يَرْحَمُنَا.*

► *Zot ynë, na jep frikë ndaj Teje aq sa kjo të na largojë nga kundërshtimi yt; na jep bindje ndaj Teje aq sa të na çojë në Xhenetin Tënd; na jep*

besim tek Ty aq sa të na lehtësojë vështirësitë e kësaj jete! O Zot, na bëj të gëzojmë dëgjimin, shikimin dhe forcën tonë, derisa të jemi gjallë dhe bëje këtë të trashëgueshme prej nesh tek pasardhësit tanë! O Zot! Hakmerru ndaj atyre që na bëjnë padrejtësi; na ndihmo ndaj atyre që na luftojnë. O Zot, mos na e bëj disfatën në fenë tonë, mos e bëj këtë botë qëllimin tonë më të madh dhe as cakun e diturisë sonë! O Zot, mos u jep pushtet mbi ne atyre që nuk na mëshirojnë!

- ◆
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْفَقْرِ، [وَالْفَاقَةِ]، وَالْقِلَّةِ، وَالذَّلَّةِ،
وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ أَنْ أَظْلِمَ أَوْ أُظْلَمَ.
 - اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ قَلْبٍ لَا يَخْشَعُ، وَمِنْ دُعَاءٍ لَا يُسْمَعُ،
وَمِنْ نَفْسٍ لَا تَسْبَعُ، وَمِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ.

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga varfëria, pamjaftueshmëria dhe poshtërimi! Kërkojmë ndihmën Tënde nga padrejtësia! O Zot! Na ndihmo të mos i bëjmë padrejtësi askujt dhe të mos na bëjnë padrejtësi të tjerët!*

► *Zot ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga ajo dituri që nuk ka dōbi, nga ajo zemër që nuk të*

frikësohet Ty, nga ai shpirt që nuk ka ngopje dhe nga ajo lutje që Ti nuk e pranon!



• اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ يَوْمِ السُّوءِ، وَمِنْ لَيْلَةِ السُّوءِ، وَمِنْ سَاعَةِ السُّوءِ، وَمِنْ صَاحِبِ السُّوءِ، وَمِنْ جَارِ السُّوءِ فِي دَارِ الْمُقَامَةِ.

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَسْتَجِيرُ بِكَ مِنَ النَّارِ
اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَسْتَجِيرُ بِكَ مِنَ النَّارِ
اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَسْتَجِيرُ بِكَ مِنَ النَّارِ.

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga dita e keqe, nata e keqe, ora e keqe, shoqëruesi i keq dhe komshiu i keq!*

► *Zoti ynë! Të lutemi të na fusësh në Xhenet dhe të na mbrosh nga zjarri i Xhehenemit!*

Zoti ynë! Të lutemi të na fusësh në Xhenet dhe të na mbrosh nga zjarri i Xhehenemit!

O Zoti ynë! Të lutemi të na fusësh në Xhenet dhe të na mbrosh nga zjarri i Xhehenemit!



• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنَّ لَكَ الْحَمْدَ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ [وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ] الْمَنَّانُ [يَا] بَدِيعَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، يَا ذَا الْجَلَالِ

وَالْإِكْرَامِ، يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ، إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ.

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنِّي أَشْهَدُ أَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، الْأَحَدُ، الصَّمَدُ، الَّذِي لَمْ يَلِدْ، وَلَمْ يُولَدْ، وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ.

► *Zoti ynë! Të lutemi Ty, sepse vetëm Ty të takojnë lavdet dhe falënderimi, sepse nuk ka zot tjetër të denjë për adhurim, përveç Teje! Ti je i Vetëm dhe i Pashoq! Ti je Dhuruesi i gjithçkaje! O Krijuesi i qiejve dhe i Tokës pa shembull të mëparshëm, o Zotërues i Madhërisë dhe Bujarisë, o i Përjetshmi, Mbajtësi dhe Mbrojtësi i gjithçkaje që ekziston; të lutemi të na fusësh në Xhenet dhe të na mbrosh prej zjarrit të Xhehenemit!*

► *Zoti ynë! O Allah! Të lutemi Ty, sepse Ti je i Vetmi, Uniku, Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka, i Cili nuk ka lindur askënd dhe nuk është i lindur prej dikujt e me të Cilin askush nuk është i barabartë!*



• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا طَيِّبًا، وَعَمَلًا مُتَقَبَّلًا.

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ بِأَنَّكَ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ، الصَّمَدُ، الَّذِي لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ، وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ، أَنْ تَغْفِرَ لِي ذُنُوبِي، إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

► *Zotí ynë! Ne kërkojmë dije të dobishme, furnizim të mirë (hallall) dhe vepra të cilat Ti i pranon!*

► *Zotí ynë! O Allah! Të lutemi Ty, sepse Ti je i Vetmi, Uniku, Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka, i Cili nuk ka lindur askënd dhe nuk është i lindur prej dikujt e me të Cilin askush nuk është i barabartë; ne kërkojmë të na falësh gjynahet! S'ka dyshim se Ti je Falësi i Madh, Mëshirëploti!*



• اللَّهُمَّ فَقِّهْنِي فِي الدِّينِ.
 • اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَشْرِكَ بِكَ وَأَنَا أَعْلَمُ، وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا لَا أَعْلَمُ
 • اللَّهُمَّ أَنْفَعْنِي بِمَا عَلَّمْتَنِي، وَعَلِّمْنِي مَا يَنْفَعُنِي، وَزِدْنِي عِلْمًا

► *Zot, na i bëj të kuptueshme fenë!*

► *Zotí ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde që mos të shoqërojmë askënd në adhurimin Tënd me*

vetëdije; dhe na fal ato gjynahe që i bëjmë pa vetëdije!

► *Zotí ynë! Na bëj dóbi me diturinë na ke dhuruar dhe na e mundëso mësimin e asaj diturie që na bën dóbi! Të lutemi, o Zot, na i shito diturinë e dobishme!*



- اللَّهُمَّ جَنِّبْنِي مُنْكَرَاتِ الْأَخْلَاقِ، وَالْأَهْوَاءِ، وَالْأَعْمَالِ، وَالْأَدْوَاءِ.
- اللَّهُمَّ قَنِّعْنِي بِمَا رَزَقْتَنِي، وَبَارِكْ لِي فِيهِ، وَاخْلُفْ عَلَيَّ كُلَّ غَائِبَةٍ لِي بِخَيْرٍ.
- اللَّهُمَّ حَاسِبْنِي حِسَابًا يَسِيرًا

► *Zotí ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga sjelljet e këqija, nga dëshirat e keqija, nga punët e këqija dhe nga sëmundjet e keqija!*

► *Zot, na bëj të kënaqur me atë që na ke dhënë, na beko në të dhe na e zëvendëso me mirësi çdo gjë që na mungon!*

► *Zot, na i lehtëso llogarinë (në Ditën e Gjykimit)!*



- اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْهَا كَمَا يُنْقَى الثُّوبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ طَهِّرْنِي بِالثَّلْجِ وَالْبَرْدِ وَالْمَاءِ الْبَارِدِ

- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبُخْلِ، وَالْجُبْنِ، وَسُوءِ الْعُمُرِ، وَفِتْنَةِ الصَّدْرِ، وَعَذَابِ الْقَبْرِ.
- اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرَائِيلَ، وَمِيكَائِيلَ، وَرَبَّ إِسْرَافِيلَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ حَرِّ النَّارِ، وَمِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ

► *Zoti ynë! O Zot, na pastro nga gjynahet ashtu sikurse pastrohen rrobat e bardha nga njollat! O Zot, na pastro nga gabimet, me ujë, borë e akull!*

► *Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde prej frikës dhe koprracisë; kërkojmë mbrojtjen Tënde prej moshës së keqe, të thyer e mjerane! O Zoti ynë, kërkojmë mbrojtjen Tënde nga gjynahet e zemrës dhe nga dënimi i varrit!*

► *Zot i Xhibrailit, i Mikailit dhe i Israfilit, kërkojmë mbrojtjen Tënde nga nxehtësia e Zjarrit dhe dënimi i varrit!*

- ◆
- اللَّهُمَّ أَلْهِمْنِي رُشْدِي، وَأَعِزَّنِي مِنْ شَرِّ نَفْسِي.
 - اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ.

► *Zot im, më bëj të drejtë e të udhëzuar në rrugën e së vërtetës; më ruaj nga e keqja e vetes!*

► *Zot! Kërkojmë dituri të dobishme dhe na ruaj nga dituria e padobishme!*



• **اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ [السَّبْعِ] وَرَبَّ الْأَرْضِ، وَرَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، رَبَّنَا وَرَبَّ كُلِّ شَيْءٍ، فَالِقَ الْحَبِّ وَالنَّوَى، وَمُنزِلَ التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ وَالْفُرْقَانِ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ كُلِّ شَيْءٍ أَنْتَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهِ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الْأَوَّلُ فَلَيْسَ قَبْلَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْآخِرُ فَلَيْسَ بَعْدَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الظَّاهِرُ فَلَيْسَ فَوْقَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْبَاطِنُ فَلَيْسَ دُونَكَ شَيْءٌ، اقْضِ عَنَّا الدَّيْنَ وَأَغْنِنَا مِنَ الْفَقْرِ.**

► *Zoti ynë! Zoti i (shtatë) qiejve dhe i Tokës, Zoti i Arshit madhështor, Zoti i ynë dhe Zoti i gjithçkaje; Zbërthyesi i farës dhe bërthamës; o Ti që shpalle Teuratin, Inxhilin dhe Furkanin (Kuranin)! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga e keqja e gjithçkaje që ke krijuar! O Zot! Ti je i Pari, para Teje nuk pati asgjë; Ti je i Fundit, pas Teje nuk mbetet asgjë; Ti je i Dukshmi i Lartë, sipër Teje nuk ka asgjë; Ti je i Padukshmi i Afërt, më pranë se Ty nuk ka asgjë! Na i shlyej borxhet dhe na pasuro!*

• اللَّهُمَّ أَلْفَ بَيْنِ قُلُوبِنَا، وَأَصْلِحْ ذَاتَ بَيْنِنَا، وَاهْدِنَا سُبُلَ السَّلَامِ،
وَنَجِّنَا مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ، وَجَنِّبْنَا الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا
وَمَا بَطَّنَ، وَبَارِكْ لَنَا فِي أَسْمَاعِنَا، وَأَبْصَارِنَا، وَقُلُوبِنَا،
وَأَزْوَاجِنَا، وَذُرِّيَّاتِنَا، وَتُبْ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ،
وَاجْعَلْنَا شَاكِرِينَ لِنِعْمِكَ مُتْنِينَ بِهَا عَلَيْكَ، قَابِلِينَ لَهَا، وَاتِمِّمَهَا
عَلَيْنَا.

► *Zotí ynë! Bashkoji zemrat tona, rregulloji raportet tona, na udhëzo në rrugën e shpëtimit, na nxirr prej errësirës në dritë dhe na largo nga paturpësitë e dukshme e të padukshme! O Zot, na e beko dëgjimin dhe shikimin; bekoji zemrat tona, gratë tona dhe pasardhësit tanë; pranoje pendimin tonë, sepse Ti, në të vërtetë, je Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti! Na bëj falënderues të mirësive të Tua dhe na i plotëso ato!*

• رَبِّ اغْفِرْ لِي، وَتُبْ عَلَيَّ، إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الْغَفُورُ
• اللَّهُمَّ ارزُقني حُبَّكَ، وَحُبَّ مَنْ يَنْفَعُنِي حُبُّهُ عِنْدَكَ، اللَّهُمَّ مَا
رَزَقْتَنِي مِمَّا أَحَبُّ فَأَجْعَلْهُ قُوَّةً لِي فِيمَا تُحِبُّ، اللَّهُمَّ مَا رَزَوْتِ
عَنِّي مِمَّا أَحَبُّ فَأَجْعَلْهُ فَرَاغًا لِي فِيمَا تُحِبُّ.

► Zoti ynë! Fali gjynahet tona dhe pranoje pendimin tonë! S'ka dyshim se Ti e pranon pendimin dhe je Falësi i Madh dhe Mëshirëploti!

► Zot, na dhuro dashurinë Tënde dhe dashurinë e atyre, që do të na bëjë dobi tek Ty! O Zot, përmes asaj që na ke dhuruar, dhe ne e duam, na jep fuqi për të realizuar atë që Ti dëshiron! O Zoti ynë, përmes asaj që na e ke larguar, dhe ne e duam, na bëj të mundur të realizojmë atë që Ti dëshiron!



- اللَّهُمَّ اعِنَّا عَلَى ذِكْرِكَ، وَشُكْرِكَ، وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ.
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ إِيْمَانًا لَا يَرْتَدُّ، وَنَعِيمًا لَا يَنْفَدُ، وَمُرَافَقَةً مُحَمَّدٍ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي أَعْلَى جَنَّةِ الْخُلْدِ.

► Zoti ynë! Na ndihmo të të përmendim, të jemi mirënjohës ndaj Teje dhe të të adhurojmë Ty sa më mirë!

► Zoti ynë! Na dhuro besim të përsosur dhe mirësi të pashtershme! O Zoti ynë, na mundëso të jemi në shoqërinë e Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në gradat më të larta të Xhenetit të përjetshëm!

- ◆
- اللَّهُمَّ قِنِي شَرَّ نَفْسِي، وَاعْزِمْ لِي عَلَى أَرْشَدِ أَمْرِي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا أَسْرَرْتُ، وَمَا أَعْلَنْتُ، وَمَا أَخْطَأْتُ، وَمَا عَمَدْتُ، وَمَا عَلِمْتُ، وَمَا جَهَلْتُ.
 - اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ غَلَبَةِ الدَّيْنِ، وَغَلَبَةِ العَدُوِّ، وَشَمَاتَةِ الأَعْدَاءِ.

- ▶ *Zot! Na ruaj nga të këqijat e vetes sonë dhe na bëj të vendosur në rrugën e drejtë! O Zot, falë gjyhet tona: ato që i kemi bërë në fshehtësi dhe ato që i kemi bërë haptazi, gabimisht apo me qëllim, me vetëdije apo nga injoranca!*
- ▶ *Zot! Të lutemi të na mbrosh nga pamundësia për të larë borxhet dhe nga paaftësia për të luftuar armiqtë! Mos ua mundëso atyre të gëzohen me dësfatat tona!*

- ◆
- اللَّهُمَّ زِدْنَا وَلَا تَنْقُصْنَا، وَأَكْرِمْنَا وَلَا تُهِنَّا، وَأَعْطِنَا وَلَا تَحْرِمْنَا، وَآثِرْنَا وَلَا تُؤْتِرْ عَلَيْنَا، وَأَرْضِنَا وَارْضَ عَنَّا.
 - اللَّهُمَّ أَحْسَنْتَ خُلُقِي فَأَحْسِنْ خُلُقِي.
 - اللَّهُمَّ ثَبِّتِي وَاجْعَلِي هَادِيًا مَهْدِيًّا.

- ▶ *Zot, na shtoj të mirat e begatitë dhe mos na i pakëso ato; na ndero dhe mos na poshtëro; na*

dhuro dhe mos na privo; na ndihmo t'i përdorim begatitë e Tua për të bërë vepra të mira dhe mos i bëj ato sprovë për ne; na bëj të kënaqur me to dhe jì i kënaqur me ne!

- ▶ *Zotí ynë! Tí na krijove në formën më të bukur, të lutemi, përsose moralin e sjelljen tonë!*
- ▶ *Zot ynë! Na forco në fe, na udhëzo dhe na e mundëso që nëpërmjet nesh të udhëzohen të tjerët!*



- *اللَّهُمَّ لَا تُخْزِنِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ.*
- *اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْمُعَافَاةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ.*
- *اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ، وَعَمَلٍ لَا يُرْفَعُ، وَقَلْبٍ لَا يَخْشَعُ، وَقَوْلٍ لَا يُسْمَعُ.*

- ▶ *Zotí ynë, mos na turpëro në Ditën e Kiametit!*
- ▶ *Zotí ynë, të lutemi na dhuro çdo gjë të mirë dhe na ruaj nga çdo gjë e keqe, në këtë botë dhe në botën tjetër!*
- ▶ *Zot! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga ajo dituri që nuk ka dobi, nga ajo zemër që nuk të frikësohet, nga ai shpirt që nuk ka ngopje dhe nga ajo lutje që Tí nuk e pranon!*

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الثَّبَاتَ فِي الْأَمْرِ، وَالْعَزِيمَةَ عَلَى الرَّشْدِ،
وَأَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ، وَعَزَائِمَ مَغْفِرَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ شُكْرَ
نِعْمَتِكَ، وَحُسْنَ عِبَادَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ قَلْبًا سَلِيمًا، وَلِسَانًا صَادِقًا،
وَأَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا تَعْلَمُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا تَعْلَمُ،
وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا تَعْلَمُ، إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ.

► *Zoti ynë, kërkohmë të na japësh
qëndrueshmëri në fenë tonë dhe vendosmëri për
të qenë të drejtë! O Zot! Të lutemi na dhuro
mëshirën dhe faljen Tënde! Të lutemi na bëj
mirënjohës ndaj mirësive të Tua dhe të të
adhurojmë sa më mirë! Të kërkohmë zemër të
mirë dhe gjuhë të sinqertë; të kërkohmë më të
mirën nga ajo që di; dhe kërkohmë strehim te Ti
nga e keqja e asaj që di; kërkohmë falje për atë që
di, sepse vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat!*

• اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي، وَعَافِنِي، أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ
ضَيْقِ الْمَقَامِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ.
• اللَّهُمَّ مَتَّعْنِي بِسَمْعِي، وَبَصَرِي، وَاجْعَلْهُمَا الْوَارِثَ مِنِّي،
وَاصْرُنِي عَلَى مَنْ يَظْلِمُنِي، وَخُذْ مِنْهُ بِثَأْرِي.

• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عَيْشَةً نَقِيَّةً، وَمَيِّتَةً سَوِيَّةً، وَمَرَدًّا غَيْرَ مَخْزٍ
وَلَا فَاضِحٍ.

- ▶ Zot, na fal, na udhëzo, na furnizo dhe na shpëto nga çdo gjë e keqe! Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga pozita e vështirë në Ditën e Gjykimit!
- ▶ O Zot, na bëj të gëzojmë dëgjimin, shikimin dhe forcën tonë, derisa të jemi gjallë dhe bëje këtë të trashëgueshme prej nesh tek pasardhësit tanë! O Zot! Na ndihmo ndaj atyre që na luftojnë dhe hakmerru ndaj atyre që na bëjnë padrejtësi!
- ▶ Zoti im, më jep jetë të begatë, një vdekje të qetë dhe një kthim jo poshtërues e as të turpshëm tek Ti!

◆
• اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْفِرْدَوْسَ أَعْلَى الْجَنَّةِ.
• اللَّهُمَّ جَدِّدِ الْإِيمَانَ فِي قَلْبِي
• اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ صَلَاةٍ لَا تَنْفَعُ .

- ▶ Zoti ynë, ne të kërkojmë Firdausin, shkallën më të lartë në Xhenet!
- ▶ Zoti ynë, ripërtëri besimin në zemrat tona!

► Zot, kërkoj mbrojtje te Ti nga ai namaz që nuk sjell dobi!



- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ، وَالْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَالْبُخْلِ وَالْجُبْنِ، وَضَلَعِ الدَّيْنِ، وَغَلْبَةِ الرَّجَالِ.
- اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ النَّارِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْفِتَنِ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الدَّجَالِ.

► Zoti ynë! Kërkojmë mbrojtjen Tënde nga dëshpërimi dhe pikëllimi, pafuqia e dembelizmi, nga frika dhe koprracia, nga pamundësia e shlyerjes së borxhit dhe padrejtësia e njerëzve!

► Zoti ynë, kërkojmë mbrojtje prej Teje nga dënimi i Zjarrit dhe dënimi i varrit; kërkojmë mbrojtje te Ti nga sprovat e dukshme dhe ato të fshehta; kërkojmë strehim tek Ti nga sprova e Dexhalit!



- اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الثَّبَاتَ فِي الْأَمْرِ، وَالْعَزِيمَةَ عَلَى الرَّشْدِ، وَأَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ، وَعَزَائِمِ مَغْفِرَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ شُكْرَ نِعْمَتِكَ، وَحُسْنَ عِبَادَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ قَلْبًا سَلِيمًا، وَلِسَانًا صَادِقًا،

وَأَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا تَعْلَمُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا تَعْلَمُ،
وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا تَعْلَمُ، إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ.

► *Zoti ynë, kërkojmë të na japësh qëndrueshmëri në fe dhe vendosmëri për të qenë të drejtë! O Zot! Të lutemi na dhuro mëshirën dhe faljen Tënde! Të lutemi na bëj mirënjohës ndaj mirësive të Tua dhe Ty të të adhurojmë sa më mirë! Të kërkojmë zemër të mirë dhe gjuhë të sinqertë; të kërkojmë më të mirën nga ajo që di; dhe kërkojmë strehim te Ti nga e keqja e asaj që di; kërkojmë falje për atë që di, sepse vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat!*



• *اللَّهُمَّ اهْدِنِي فِيمَنْ هَدَيْتَ، وَعَافِنِي فِيمَنْ عَافَيْتَ، وَتَوَلَّنِي فِيمَنْ تَوَلَّيْتَ، وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَ، وَقِنِي شَرَّ مَا قَضَيْتَ، إِنَّهُ لَا يَذِلُّ مَنْ وَالَيْتَ، تَبَارَكْتَ رَبَّنَا وَتَعَالَيْتَ.*
• *رَبِّ اغْفِرْ لِي خَطِيئَتِي يَوْمَ الدِّينِ.*

► *Zoti ynë! Na bëj prej atyre që i ke udhëzuar në rrugën e drejtë! Na bëj prej atyre që i shpëton nga të këqijat! Na bëj prej atyre që kujdesesh për ta! Na e bëj të begatshme gjithçka që na ke dhënë (si: jetën, pasurinë, njohuritë, punët)! Na*

*ruaj nga sherri i asaj që Ti ke caktuar për ne!
Nuk mund të jetë i poshtëruar ai që Ti e ke
miqësuar dhe nuk mund të bëhet krenar ai që Ti
e ke armiqësuar! O Zotí ynë! Ti je i Bekuar dhe i
Lartësuar!*

► *Zot, na i fal mëkatet në Ditën e Gjykimit!*



- *أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الْعَظِيمَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ، الْحَيُّ الْقَيُّومُ، وَأَتُوبُ
إِلَيْهِ.*
- *اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، وَأَذْهَبْ غَيْظَ قَلْبِي، وَأَعِدْني مِنْ مُضِلَّاتِ
الْفِتَنِ.*
- *اللَّهُمَّ أَحْيِنِي عَلَى سُنَّةِ نَبِيِّكَ وَتَوَفَّنِي عَلَى مِلَّتِهِ، وَأَعِدْني مِنْ
مُضِلَّاتِ الْفِتَنِ.*

► *Kërkoj falje nga Allahu Lartmadhëruar,
përveç të Cilit nuk ka zot tjetër që meriton
adhurimin; Ai është i Gjallí, i Përjetshmí,
Mbajtësi i gjithçkaje; dhe tek Ai pendohem!*

► *Zotí ynë, na i fal mëkatet; largo zemërimin
nga zemrat tona dhe n mbro nga devijimet e
tundimit!*

► *Zotí ynë, na bëj ndjekës besnikë të Sunetit të
të Dërguarit Tënd (Paqja e Allahut qoftë mbi
të!) gjatë gjithë jetës; na e mundëso të ndërrojmë*

*jetë në miletin e tij (në fenë dhe besimin e tij);
dhe na ruaj nga mëkatet shkatërruese!*

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ،
وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ
مُحَمَّدٍ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ، وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، [فِي الْعَالَمِينَ]
إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

*O Allah, lavdëroje (tek melekët e lartë)
Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç
lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti
je i Lavdishëm dhe i Madhëruar.*

*O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e tij,
ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij,
vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar!*

*Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të
botëve, me mirësinë e të Cilët kryen veprat e mira. Paqja,
bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për robin dhe të
Dërguarin e Tij, Profetin tonë Muhamed, për familjen dhe
shokët e tij.*

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

الَّذِي بِنِعْمَتِهِ تَتِمُّ الصَّالِحَاتُ

وَ صَلَّى اللَّهُ عَلَى عَبْدِهِ وَ رَسُولِهِ نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ

وَ عَلَى آلِهِ وَ صَحْبِهِ وَ سَلَّمَ

Përmbajtja

Parathënie.....	3
Kapitulli I: Të njohim Medinen e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).....	4
Kapitulli II: Udhëzuesi për kryerjen e riteve në Xhaminë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).....	26
Kapitulli III: Ihrami si hapi i parë në udhëtimin tuaj të besimit	40
Kapitulli IV: Udhëzues për kryerjen e riteve të umres.....	51
Kapitulli V: Të njohim Mekën - Kryeqytetin e Shenjtë... 	65
Kapitulli VI: Lutje nga Kurani dhe Suneti.....	88
Përmbajtja.....	134